



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Kurbin

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI
Auditimin Financiar

BASHKIA KURBIN

Tiranë, Tetor 2024

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE	3-6
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
II.	HYRJA	6-11
1	Objektivat dhe qëllimi	6-7
2	Identifikimi i çështjes	7-7
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7-7
4	Përgjegjësitë e audituesve	7-8
5	Kriteret e Vlerësimit	8-9
6	Standartet e auditimit	9-9
7	Metodat e auditimit	9-10
8	Dokumentimi i auditimit	10-11
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	11-67
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11-12
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	12-67
2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	12-21
2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	21-24
2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2023	24-31
2.3	Mbi burimin e krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre	31-44
2.4	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023	44-62
2.5	Mbi administrimin e pronës publike	62-66
2.6	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	66-67
IV.	REKOMANDIME	67-75
V.	ANEKSE	76-84

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia **Kurbin** është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe tre ish-komunave në afërsi të tij, pra në total ka 4 njësi administrative si vijon: njësia administrative Laç (qyteti), Mamurras, Milot dhe Fushë Kuqe, Qyteti Kurbin.

Misioni i Bashkisë Kurbin është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Kurbin si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Kurbin si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financiacimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësim me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga Bashkia Kurbin. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi burimin e krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në pasqyrat financiare.
- mbi administrimin e pronës publike.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 17 gjetje dhe ka dhënë 19 rekomandime, nga ku masa organizative me 9 gjetje - rekomandime, 1 gjetje-rekomandime për shpërblim dëmi, 7 gjetje dhe 9 rekomandime në vlerën 383,751 mijë lekë në fushën për uljen e borxhit tatimor, për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore.

f. **Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ **Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave**

- Të ardhura të pa arkëtuara në vlerën 57,405 mijë lekë nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit dhe institucione.

- Të ardhura të pa arkëtuara në vlerën 65,686 mijë lekë nga mosarkëtimi I debitorëve të taksës familjare.

- Të ardhura të pa arkëtuara në vlerën 131,152 mijë lekë nga mosarkëtimi i taksës së tokës nga fermerët debitorë.

- Të ardhura të pa arkëtuara në vlerën 50,742 mijë lekë nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Nga auditimi i veprimeve të bankës për vitin 2023, u konstatua:

Shpenzime për pastrimin, gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.

Nga auditimi i dokumentacionit të pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes varrezave të bashkisë Kurbin dhe 3 njësive administrative për vitin 2023, u konstatuan mangësi dokumentare, konkretisht:

* Mungojnë informacionet mujore dhe procesverbalet ditore për pasqyrimin e vërejtjeve dhe zbritjeve për punë të pakryera të konstatuara, në kundërshtim me pikën 8 të rregullores brendshme të bashkisë.

* Në situacionet mujore nuk pasqyrohet asnjë zbritje të punimeve të pakryera të pastrim, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes varrezave si dhe nuk pasqyrohen ditët me shi për gjithë vitin 2023.

* Në situacionet mujore nuk ka asnjë zbritje për fshirjet e rrugëve, shesheve, trotuareve, të cilat kanë qënë të zëna nga rikonstruksionet për vitin 2023, objekt investimesh, konkretisht: Për investimin “rikonstruksion rruga lagjja nr. 2 Laç” u konstatua sipërfaqja 3,720 m² dhe 710 m² e zënë nga punimet me asfaltbeton në rrugë e trotuare, për periudhën 3-mujore (Janar-Prill 2023), sipas kontratës 30.01.2023 dhe situacionit nr. 1 datë 11.04.2023 si dhe urdhër shpenzimit nr. 654 datë 05.05.2023, rezulton vlere 13,820 lekë për punë të pakryera nga firma e pastrimit “B” shpk, përkatësisht sipas zërave të punës:

-Zëri “Fshirje rruge, trotuare” për sipërfaqen 3720 + 710 m² x 0.91 x 3 muaj =12,093 lekë.

-Zëri “Mirëmbajtje rrugëve”, sipërfaqen 3,720+710 m² x 0.13 x 3 muaj = 1,727 lekë.

-Zëri “Mirëmbajtje varrezash dhe hapësirave publike” nuk zbërthehet në zëra analitike sipas zërave të punës, por pasqyrohet në vlerë absolute për 484,999 lekë, vlerë të njëjtë për çdo muaj. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga auditimi i aseteve të bashkisë Kurbin për vitin 2023, lidhur me kontabilizimin dhe pajisjen me certifikatë pronësie të tyre, u konstatua se: Bashkia Kurbin disponon gjithsej 3,309 prona të paluajtshme, përkatësisht: shkolla, troje, sheshe, pemëtore, zyra, rrugë, pyje, kullota. Regjistrimi në kontabilitet i aseteve është bere pjesërisht nga bashkia Kurbin. Bashkia Kurbin ka regjistruar në kontabilitet 164 prona të paluajtshme, përkatësisht troje, rrugë, ndërtesa, rrjete etj., me vlerë totale 3,191,209,826 lekë në vlerë historike.

* **3,145 prona të paluajtshme nuk janë regjistruar në kontabilitet**, këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ndryshuar me ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”.

* **3,309 prona të paluajtshme nuk janë pajisur me certifikatë pronësie** pranë ASHK Lezhë, madje nuk ka pasur as aplikime për vitin 2023.

* **Pyje dhe kullota publike të transferuara** brenda juridiksionit të territorit të bashkisë Kurbin, rezulton sipërfaqja prej 11,350 ha, nga kjo 154 ha kullotë dhe 11,196 ha pyll, të cilat nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe nuk janë pajisur me certifikatë pronësie pranë ASHK Lezhë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Kurbin të marrë të gjitha masat për të arkëtuar vlerën **13,820 lekë** për punë të pakryera nga firma e pastrimit “B” shpk.

- Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Bashkia Kurbin në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të patakshuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej **131,152 mijë lekë**, nga taksa e tokës bujqësore.

- Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shpresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

- Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Bashkia Kurbin të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej **17,400 mijë lekë**, kjo për 16 subjekte e pasqyruar në kapitullin Anekse, tabela nr. 34 bashkëngjitur Raportit të Auditimit.

- Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK Sh.A Kurbin me qëllim që taksat dhe tarifat vendore për kategorinë “Familjar” të mbliidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.

Drejtorja e të Ardhurave Bashkia Kurbin të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **65,686 mijë lekë**, nga abonentët familjare, me qëllim eliminimin e të ardhurave të pa arkëtuara për buxhetin e bashkisë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinion mbi Pasqyrat Financiare të vitit 2023:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar vetëm pasqyrat financiare të aparatit të Bashkisë Kurbin për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Bashkia Kurbin nuk ka hartuar pasqyra të konsoliduara pasi nuk ka njësi shpenzuese në varësi. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Kurbin më 31 dhjetor 2023, referuar kuadrin rregullator; Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet 9 Kombëtare të Kontabilitetit; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur

Baza për opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti Bashkia Kurbin, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 35,175 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

“Theksimi i çështjes”.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, e cila paraqitet me probleme, pasi ka vlerë të lartë për 376,772 mijë lekë, që përfaqëson debitorët e taksave vendore, taksës infrastrukturës ALUIZNI dhe debitorë të tjerë, grafiku i se cilës është në rritje për 57,763 mijë lekë, krahasuar me vitin e mëparshëm 2022.

Bashkia Kurbin disponon gjithsej 3,309 prona të paluajtshme, përkatësisht: shkolla, troje, sheshe, pemëtore, zyra, rrugë, pyje, kullota. Regjistrimi në kontabilitet i aseteve është bërë pjesërisht nga bashkia Kurbin. Bashkia Kurbin ka regjistruar në kontabilitet 164 prona të paluajtshme, përkatësisht troje, rrugë, ndërtesa, rrjete etj., me vlerë totale 3,191,209 mijë lekë në vlerë historike.

* 3,145 prona të paluajtshme nuk janë regjistruar në kontabilitet

* 3,309 prona të paluajtshme nuk janë pajisur me certifikatë pronësie pranë ASHK Lezhë, madje nuk ka pasur as aplikime për vitin 2023.

* Pyje dhe kullota publike të transferuara brenda juridiksionit të territorit të bashkisë Kurbin, rezulton sipërfaqja prej 11,350 ha, nga kjo 154 ha kullotë dhe 11,196 ha pyll, të cilat nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe nuk janë pajisur me certifikatë pronësie pranë ASHK.

-Bashkia Kurbin, në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, nuk ka kryer verifikime dhe saktësimet përkatëse në terren, për të ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor, brenda juridiksionit të saj administrativ, pasi të dhënat që disponohen nga kjo bashki, i referohen statistikave para vitit 1990. Gjithashtu nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonominë pyjore, si dhe nuk ka proceduar për regjistrimin e tyre në regjistrat kadastral.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot., 750/1, datë 07.06.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 12.06.2024 deri në datë 10.07.2024, në subjektin Bashkia Kurbin për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1.A. G, përgjegjës grupi;
- 2.L. K, auditues;
- 3.B. B, auditues;
- 4.K. F, audituese.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1.Objekti dhe qëllimi i auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Kurbin kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)³;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Objekti i auditimit financiar në Bashkinë Kurbin është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kurbin, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

- 1.Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
- 2.Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- 3.Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
- 4.Raportimi financiar;
- 5.Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Kurbin (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Përgjegjësi i Sektorit të Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontroleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Kurbin, Përgjegjësi e sektorëve pranë Bashkisë Kurbin kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që në të përbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”.

- *Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:* Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; Ligji nr. 137/2020 “*Për buxhetin e vitit 2021*” dhe Ligji nr. 115/2021 “*Për buxhetin e vitit 2022*”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i

ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2023”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- **Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*¹. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohem nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

¹ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit.

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Me shkresën nr. 750/3, datë 06.08.2024, nga grupi i auditimit të KLSH është nisur Projektraporti i Auditimit në të cilën u evidentuan mangësitë e konstatuara gjatë procesit të auditimit, mangësi të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjor gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Kurbinit shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me bashkitë Lezhë dhe Mirditë, në lindje me bashkinë Mat, në jug me bashkitë Krujë dhe Durrës dhe në perëndim me Detin Adriatik.

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Kurbini ka 46,291 banorë, ndërsa sipas regjistrimit civil ka 72,987 banorë. Me një sipërfaqe prej 269.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 172 banorë km², ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 271 banorë km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e re Kurbinit shtrihet në një zonë bujqësore dhe pjesërisht malore në Shqipërinë qendrore dhe ka një vijë bregdetare, që shtrihet në rezervatin natyror Patok-Fushë Kuqe.

Kurbini gjendet përgjatë aksit rrugor dhe hekurudhor veri-jug, gjë që ka sjellë edhe zhvillimin e shërbimeve të transportit. Qyteti i Laçit, i cili ka një të tretën e popullsisë së bashkisë së re, është një zonë ish-industriale dhe është krijuar si qytet përreth fabrikave të Superfosfatit dhe të pasurimit të bakrit, që të dyja të mbyllura shumë kohë më parë. Fasoni ka zëvendësuar këto fabrika si burimi kryesor i punësimit në qytet. Megjithatë, sot funksionon vetëm një fabrikë të prodhimit të këpucëve, ku janë të punësuar 100 gra. Papunësia është tepër e lartë.

Pjesa tjetër e bashkisë është zonë bujqësore, ndërsa me rëndësi konsiderohet Laguna e Patokut, e cila është zhvilluar si zonë peshkimi dhe qendër e turizmit ditor.

Bimësia është e shpërndarë sipas kushteve klimatike, duke formuar zonën e shkurreve mesdhetare (zhvillohen shkurret, kryesisht shqopa e mareja), e dushqeve (lisi, gështenja), e ahishteve (ahu) dhe e halorëve (pisha). Duke u nisur sipas vetive të përdorimit në zonë rriten edhe bimët mjeksore e aromatike, që përmbajnë lëndë aktive dhe esenca.

Misioni i Bashkisë Kurbini është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. duke garantuar vetë-qeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Bashkia Kurbin, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë. Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Kurbin për periudhën e aktivitetit të vitit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektiv, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

III.2.1. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

1.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditin i Brendshëm.

Në zbatim të pikës 2.1.1 të programit të auditimit: “**Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm**”. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar në sesistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Kurbin, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Kurbin ka të miratuar Kodin e Etikës, në vitin 2016, ku janë përcaktuar veprimet që parandalohen në kapitulli II “Etika dhe sjellja etike”, kapitulli III “Etika e paraqitjes” dhe të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes. Ndërsa në kapitullin “Sanksionet” për procedurat disiplinore për shkeljen e rregullave të etikës së shërbimit civil, mos plotësim të detyrave, thyerjes së disiplinës si dhe rastet e tjera të parashikuar nga ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojnë cdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Njohja e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

-Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, janë hartuar rregullore, ku një rregullore nr.156, datë 27.11.2017 “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Kurbin” dhe rregulloren nr.4, datë 28.01.2020 “Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Bashkinë Kurbin”. Gjithashtu në rregulloren e brendshme neni nr.25 është përcaktuar procedura për sinjalizimin.

Në të cilat janë përcaktuar veprimet që parandalohen, ndëshkimin e rasteve, procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës. Për shkeljet administrative në lidhje me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit publik”, në nenin 20 të Rregullores së Brendshme, janë parashikuar përgjegjësia administrative dhe detyrat e koordinatorit të së drejtës për informim. Për çdo vit është hartuar raporti i Njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, me shkresat përkatëse, depozituar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesave (ILDKPKI). Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen, por në vitin 2023, punonjës të Bashkisë Kurbin kanë marrë pjesë në trajnime online të zhvilluara nga ASPA për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

-Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e protokollit), zyrës me një ndalesë dhe koordinatorit të informimit publik, duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë, këto struktura janë të përcaktuara, në nenin 20 (koordinatori publik), neni 35/26 (zyra me një ndalesë) dhe neni 35/22 zyra e protokollit të Rregullores së Brendshme.

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në vit.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushë veprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e raportimit, realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA drejtuar Nënkretarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Ky rregull jo gjithmonë është ndjekur për periudhë mujore, por raportimi është realizuar për periudha 3-mujore e 6-mujore. Ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

-Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Kurbin me Vendimin e Kryetarit nr.07 datë 24.11.2016 dhe ka një ndarje të detyrave dhe funksioneve.

-Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të tryezave të rumbullakëta me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për dëgjesat me publikun.

-Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

-Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri njëfarë mase.

-Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë, me Vendim të Kryetarit nr.104 datë 21.12.2022 “Për miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin, Njësi Administrative dhe Institucioneve në varësi për vitin 2023”. Numri i punonjësve është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.2 datë 09.01.2023, me 522 punonjës nga ku; në administratën e Bashkisë 224 (dyqind e njëzet e katër) punonjës; në njësitë administrative 57 (pesëdhjetë e shtatë) punonjës; në institucionet në varësi 241 (dyqind e dyzet e një) punonjës.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë së saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, si dhe janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

Në Bashkinë Kurbin, funksionin shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht funksionojnë sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike, sipas rregullores së brendshme. Mënyra e shkëmbimit të informacionit dokumentar dhe elektronik është përcaktuar në pjesë të veçanta të Rregullorës së Brendshme të Bashkisë Kurbin, nenet 21-22 nenet 28-29 dhe kreu VI “Administrata e Bashkisë”. Kanë funksionuar linjat e komunikimit të jashtëm në lidhje me dhënien dhe marrjen e informacionit për njësitë vartëse jashtë Bashkisë Kurbin por edhe të tretë jashtë sistemit. Është funksionale faqja ëeb-Bashkia Kurbin, në të cilën ka informacione relativisht mjaftueshëm për aktivitetin, veprimtarinë, raporte monitorimi mbi realizimin e planeve vjetore, etje., por është evidentuar mangësia si më poshtë: Sa i përket komunikimit të brendshëm, nuk janë identifikuar, hartuar dhe miratuar llojet e raportimit brenda strukturave të bashkisë, më funksion të monitorimit të realizimit të objektivave strategjike dhe vjetorë të përcaktuara në planet përkatëse.

-Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

-Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, dhe ka plan vjetor të miratuar me shkresën nr. 5000 Prot., datë 31.10.2023. Në 3 raste të testuara të rekrutimit rezultoi se ishin kryer procedurat në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil. Për çdo punonjës të rekrutuar

krijohet dosja personale, e cila përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, etj.

-Ka një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Gjithashtu nga Bashkia Kurbin ka hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila ti dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave. (mungojne të dhënat për trajnime jashtë institucionit).

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. PBA dhe buxhetet vjetore janë miratuar me VKB përkatëse për çdo vit. NA për vitin 2023 ka nxjerrë Urdhrat e ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

-Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Financës.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

Në Rregulloren e Brendshme në pikën (27.1) të nenit 27 është parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin e institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi ka patur Autorizime apo Urdhëresa për delegime detyrash dhe konkretisht me Vendimin nr. 9 datë 08.09.2023 është bërë delegimi kompetencave për nënshkrimin e korrespondencës shkresore për dy Z/Kryetarët e Bashkisë.

-Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore” Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2023 për hartimin e PBA 2023-2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me 9 anëtarë (1 anëtar pa të drejtë vote) dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve për 19 programe buxhetore me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.7, datë 09.02.2022. Është miratur Udhëzuesi i brendshëm nr.1 date 05.04.2022 “Për përgatitjen e PBA në Bashkinë Kurbin”.

Nga verifikimi rezulton se GSM nuk i ka kryer detyrat si:

- Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Bashkia Kurbin në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva ashtu dhe në planet operationale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me

vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Kurbin. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla dhe rezultojnë kryesisht me përcaktimin e prioriteteve në realizimin e objektivave.

-Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon rrisqet për arritjen e objektivave”.

Në Bashkinë Kurbin ka përpjekje për krijimin e një praktike apo strategjie të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Bashkia Kurbin ka ngitur Urdhër të Titullarit për përcaktimin e koordinatorit të riskut urdhëri nr. 20 datë 31.01.2023 me nr. 698/1 prot., ku përcaktohet edhe grupi i punës për menaxhimin e riskut. Është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi i risqeve për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe të gjithë drejtorive, ku janë evidentuar risqet dhe janë përcaktuar veprime për të adresuar mangësitë, është hartuar plani i veprimit për menaxhimin e riskut.

Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskt për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, rryshfetit dhe korrupsionit.

-Në Rregulloren e brendshme janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut por jo të grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”

Bashkia Kurbin në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, per arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.).

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Financës/ Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA). Struktura e Drejtorisë së Financës përbëhet nga 18 punonjës, 1 drejtor, 3 përgjegjës Sektori dhe 14 specialistë sipas sektoreve.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NjHDT dhe KVO janë parashikuar edhe në nenin 32 të Rregullores së Brendshme.

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

-Në Rregulloren e Brendshme neni 23 dhe neni 35 “Specialisti i Arshivës”, përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislationit për arkivat.

-Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshme në detyrat e drejtorisë së Financës nenet 36 (36.1-36.16), por për menaxhimin e tyre veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pikësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

-Bashkia Kurbin ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe ka plan investimesh për programet e IT.

Në rregulloren e brendshme të Bashkisë Kurbin janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të IT. Faqja Zyrtare e bashkisë Kurbin në internet ka një sistem back-up.

Ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij.

Ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra ka gjurma të auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

-Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuara në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, dhe është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

-Në nenet 36 (36.1-36.16) të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transakcioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

-Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merren Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Planifikimit Zhvillimit Kontrollit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike;

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga specialistët e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilzimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e

bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga AB ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”, i ndryshuar). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Drejtuesit në Bashkinë Kurbin kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit ofron sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.

-Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujore dhe vjetore dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit. Ka Raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak, konkretisht për 4-mujorin e parë është hartuar dhe dërguar roporti i monitorimit me shkresën nr. 2583 prot., datë 25.05.2023 (janar-Prill), për 4-mujorin e dytë është hartuar dhe dërguar raporti me shkresën nr. 4360 prot., datë 28.09.2023, dhe për vitin 2023 është dërguar me shkresën nr. 1029 prot., datë 27.02.2024. Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e shtojcës 2. Përmbajtja e raportit të monitorimit dhe shtojcës 5. “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiare”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, pika 10, 12, 28, 29 dhe 40.

-Raportet për detyrimet e konstatuara, por të papaguara hartohen çdo 4 muaj janë paraqitur në degën e thesarit dhe MFE me shkresat për 4-mujorin e parë janar-prill 2023 dërguar me shkresën nr. 2622 prot., datë 30.05.2023, për periudhën janar-gusht me shkresën nr. 4336 datë 27.09.2023 dhe për vitin 2023 me shkresën nr. 1028 prot., datë 27.02.2024. Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2023 është në vlerën 55,981 mijë lekë. Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llog. e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.

-Drejtoria e Financës në Bashkinë Kurbin për mbajtjen e kontabilitetit operon me program excel. Regjistrimet apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Specialistët e Financës. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Financës dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel dhe program të veçantë që i menaxhon Drejtoria e të Ardhurave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit Kurbin për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Për lëvizjet AAGJM mbahen dokumenta financiarë dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Për aktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimi kryhen procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm. Ka faqen e saj zyrtare.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet: neni 17 deri në nenin 20.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar.

Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo 4 muaj dhe nëpërmjet analizave të herë pas hershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Në përdorimin e emailit zyrtar kanë akses të gjithë punonjësit, por komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Kurbin janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

-Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Bashkia Kurbin kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti bëhen në takimet me titullarin, por nuk pasqyrohen në raporte të shkruara nga gjithësecili. Operohet vetëm me proces verbale të mbajtura nga protokollin e analizës së bërë.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen e objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokumenti i cili hartohet çdo 4 muaj. Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit. Ka Raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak, konkretisht për 4-mujorin e parë është hartuar dhe dërguar roporti i monitorimit me shkresën nr. 2583 prot., datë 25.05.2023 (Janar-Prill), për 4-mujorin e dytë është hartuar dhe dërguar raporti me shkresën nr. 4360 prot., datë 28.09.2023, dhe për vitin 2023 është dërguar me shkresën nr. 1029 prot., datë 27.02.2024. Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, pika 10, 12, 28, 29, 40.

Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen e objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokumenti i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

-Për vitin 2023 me shkresën nr. 1075 prot., datë 29.02.2024, të cilat janë dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Kurbin dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësonin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.
4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

-Në Bashkinë Kurbin ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e SMF dhe kontrollit. Është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK sipas afateve ligjore branda muaji shkurt me datë 28.02.2023.

-Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH, ndërsa nga Auditit i brendshëm nuk ka rekomandime.

-Në Bashkinë Kurbin aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi ka vetëm një Raport për Zbatimin për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e pa shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm për auditimet në institucionin e bashkisë në drejtorit përkatëse sipas planit të auditit të realizuar në vitin 2023, duke u shprehur në të njëjtin format dhe për të gjitha subjektet e audituara.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetaren e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

-Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditimi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet planveprimtari për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Konkluzion:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

Ka një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit por nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezultoi se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet.

“Menaxhimi i Riskut”

Është përcaktuar koordinatori i riskut me rregullore, është ngritur grupi i punës së riskut, janë identifikuar risqet sipas drejtorive është regjistri i riskut dhe është bërë vlerësimi i të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm është hartuar plani i veprimtari për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Ka evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Kurbin ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT. Pra ka gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III.2.1.1. Auditim mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- ❖ Plani Strategjik dhe Vjetor për periudhën 2023-2025.
- ❖ Raporti vjetor 2023 dhe pasqyrat e miratuara.
- ❖ Dosjet e auditimit për vitin 2023.
- ❖ Karta e Auditimit të Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kurbin.

Tabela nr.1, Organika e miratuar për Bashkinë Kurbin, paraqitet si vijon:

Nr.	Emertimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish (fakt) 2023
1	Përgjegjës Sektori	1	0
2	Specialist	2	1
Total		3	1

Burimi: Njësia e Auditit të Brendshëm.

Në zbatim të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, duke përbushur detyrimin ligjor të pavarësisë i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Kapaciteti auditues i strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Kurbin, është bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar. NJAB Kurbin ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me VKB nr. 176 datë 28.12.2017, i përberë nga dy specialist dhe një përgjegjës. Për vitin 2023, Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 përgjegjës dhe 1 specialistë deri me 15.06.2023 më pas me 1 specialistë. Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kurbin është e organizuar si Njësi në varësi të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Bashkisë. Struktura e personelit të Njësisë është:

- ❖ Ekonomist 1 Specialist Sektori. Punonjësi i sektorit të AB është i pa certifikuar si "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", në bazë të Ligjit Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" çka bie në kundërshtim me ligjin.
- ❖ Për periudhën Janar-Qershor 2023, Sektori i Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 punonjës, specialist i auditit të brendshëm.
- ❖ Me urdhërin nr. 5720 prot., datë 20.11.2018, është miratuar nga Kryetari i Bashkisë "Karta e Auditimit të Brendshëm", kjo bazuar në ligjin Nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik" në nenin 4 pika "12", në nenin 12 pika "c"), me përcaktimin e statusit organizativ, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmëritë dhe përgjegjësitë e auditit të brendshëm.
- ❖ Gjatë periudhës së auditimit, në Bashkinë Kurbin struktura e sektorit të Auditit, nuk ka qenë e plotësuar.

-Njësia e AB në Bashkinë Kurbin mbulon me auditim:

1. Njësia Administrative Mamurras.
2. Njësia Administrative Milot.
3. Njësia Administrative Fushë-Kuqe si edhe të gjithë drejtoritë dhe agjensitë në vartësi të Bashkisë Kurbin.

➤ **Komiteti i Auditit të Brendshëm:**

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 13 "Komitetit të Auditimit të Brendshëm" i cili përcakton se: "Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
- b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;

- c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
- ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
- d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
- dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

➤ Viti 2023

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 18 tetor e çdo viti pranë DHAB, brenda afatit ligjor.

Me shkresën nr. 4977, datë 18.10.2022, është dërguar Plani Strategjik dhe Vjetor i veprimtarisë së NJAB, për Bashkinë Kurbin për vitet 2023 – 2025, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit për Auditin e Brendshëm. Me shkresën nr. 668/1, datë 14.02.2024, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Kurbin për vitin 2023, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit për Auditin e Brendshëm.

-Plani Strategjik për periudhën 2023 – 2025, përbëhet nga:

Pasqyra Nr.1- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2023

Pasqyra Nr.2 - Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2023-2025.

Pasqyra Nr.3- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2023

Pasqyra Nr.4 – Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2023

Pasqyra Nr.5 – Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2023
Në planin vjetor të angazhimeve të auditimeve janë përcaktuar objektivat për tu audituar. Sipas kësaj pasqyre janë përcaktuar për tu audituar në vitin 2023, gjithsej 2 njësi.

- ❖ Auditim Përputhshmërie në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Kujdesit social.
- ❖ Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Auditin e Brendshëm në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Tabela nr.2, Planifikimi dhe realizimi 2023

Nr.	Planifikimi 2023	Realizimi 2023
1	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Kujdesit Social (2 sektoret)	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Kujdesit Social (2 sektoret)
2	Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga NJAB	Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga NJAB

Burimi: Njësia e Auditit të Brendshëm

Për periudhën raportuese janë realizuar gjithsej 2 angazhime nga 2 angazhime të planifikuara, ose 100% e planit. Referuar Raporteve të Auditimit për cdo angazhim janë identifikuar gjithsej 7 gjetje.

➤ Dosjet e audituara për vitin 2023

1. Me urdhër shërbimin me nr. 4803 prot., datë 19.10.2023 është urdhëruar kryerja e misionit të auditimit në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Kujdesit Social. Bazuar në shkresën nr. 4803/7 prot., datë 30.11.2023 është dërguar raporti përfundimtar në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Kujdesit Social (DNE). Subjekti është audituar për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. Nga kontrolli i dosjes rezulton se mungon vlerësimi i riskut. Nga ky auditim kanë dalë gjithsej 5 gjetje nga ku një me dëm ekonomik 11,804 lekë.

2. Në periudhën raportuese është kryer angazhimi i auditimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga NJAB, programi nr. 5556/3 datë 01.12.2023, për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga NJAB. Dosja rezulton me dokumentacion të rregullt. Nga kontrolli rezulton se nga katër rekomandime të lëna janë zbatuar tre ose 75%.

➤ **Nisur nga sa më sipër, grupi audituesve, ka konstatuar si më poshtë vijon:**

- Struktura e NJAB e paplotësuar.
- Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimeve të kryera në vitin 2023, nuk është në përputhje me Urdhërin nr. 4 datë 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Konkretisht, rubrika e gjetjeve dhe rekomandimeve nuk është organizuar në formë tabelore sipas përcaktimeve të aktit të mësipërm. Nuk është përfshirë në strukturën e Raportit Përfundimtar dhe Projekt-Raportit, Opinioni i Përgjithshëm i grupit të audituesve lidhur me njësinë e menaxhimit të audituar, duke rënë persëri në kundërshtim me përcaktimet e Urdhërit nr. 4. datë 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Struktura e Raportit mbi Veprimtarinë Vjetore të NJAB dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk përmban rubrikën e Prioriteteve për Vitin e Ardhshëm.
- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka celur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, këto veprime janë në kundërshtim me paragrafin 6.3, Kreun 6 të Manualit të Brendshëm të Auditimit.
- Nuk është dërguar memo e grupit të auditimit drejtuar titullarit të institucionit.
- Në përgjithësi nga NJAB është respektuar procedura e auditimit në përputhje me bazën ligjore dhe manuali i auditimit të brendshëm.
- Në dosjen e Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Kujdesit Social ka mungesë dokumentacioni.
- Nga auditimi u konstatua se janë respektuar afatet e auditimit, ku me saktësisht, raporti përfundimtar i auditimit referuar manualit për manxhimin financiar duhet ti dërgohet subjektit 7 ditë pune pas reagimit të subjektit, afat i cili është respektuar.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III.2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023:

- ***Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2023-2025***

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025 rezultoi se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr. 7.datë 09.02.2022 mbi bazën e të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë prej 9 punonjësish dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP). Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxheti i vitit 2023, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

- Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 është miratuar me VKB nr. 61 datë 27.07.2022 nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025".

- Në këtë programim është përgatitur dhe përfshirë instrumenti i planifikimit financiar, shoqëruar me relacionin shpjegues i cili është dërguar në MFE me shkresën nr. 2894 prot., datë 30.05.2022 dhe përbëhet nga struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimet e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2023-2024-2025.

-Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

-Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2023-2025 dhe buxheteve vjetore, rezulton se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative dhe nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kurbin në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, si dhe kërkesa nga sektorë të ndryshëm, që mbulojnë këto programe.

-Në fazën përfundimtare të PBA, duke i'u referuar realizimeve të viteve paraardhëse si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat.

-Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresën nr. 2894 prot., datë 30.05.2022.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”.

- Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2023

Për vitin 20223 buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 106 datë 21.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr. 967/6 prot., datë 30.12.2022, i paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr.3, Plani i buxhetit të vitit 2023.

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	156,676	
2	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	343,472	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	184,661	
4	Te ardhura te trasheguara nga viti 2022	119,745	
5	Te ardhura jashte limitit	3,003	
8	Paga (600)		324,175
9	Sigurime shoqërore (601)		53,120
10	Shpenzime operative (602)		255,211
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		38,754
12	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		136,298
13	Investime ne proces		
Totali i buxhetit		807,558	807,558

Burimi: Drejtoria e Financës.

Sipas tabelës së mësipërme buxheti i vitit 2023, është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 807,558 mijë lekë.

- Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.4, PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023.

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)	377,295	325,743	51,552
2	Shpenzime (602.shp Op.+604 nd.ek.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	293,965	211,566	82,399
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	136,298	78,019	58,279
4	Investime nga FZHSH			
Total I planit fillestar		807,558	615,328	192,230
Shtesat nga Pushteti Qendror				
5	Investime grant i kushtëzuar			

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
6	Shpenzime për pagat (600+601)			
7	Shpenzime (602,604,609)			
8	Grant i kushtëzuar (230-231)			
0	Gjithsej			

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2023 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2023-2025, rezulton se ka një diferencë prej 192,230 mijë lekë. Kjo ka ardhur kryesisht ngaqë në PBA nuk është e parashikuar e ardhura që do të trashëgohet nga viti paraardhës.

➤ **Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kurbin dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Kurbin dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Kurbin. Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.5, Ndryshimet gjatë vitit në buxhet.

000/lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Pakësuar/shtuar artikulli (me emër)			
	Nr./datë	Vlera	Nr./datë	Vlera	Shtesa art.	shuma	Paksime art.	Shuma
Viti 2023	Nr.106,dt.21.12.2022	807,558	VKM.328 dt 31.05.23 Akordim fondi per rritje pagash	16,862	600 pagat 601 sig shoq	14,505 2,357		
Viti 2023			VKB.13 DT.21.07.23	490	606 Emergj Civile	490	609	490
Viti 2023			VKB.28.Dt.23.11..23	10,000	602 Transf Pakushtez Detyrime	10,000		
Viti 2023			VKM.677.dt.06.12..23	1,159	604.F.Rindertimit	1,159		
Viti 2023			VKB.47.dt.19.12.23	33,879	602 Transf Pakushtez Detyrime	33,879		
					Shtesa total	61,900		

Burimi: Drejtoria e Financës.

Nga sa më sipër konstatohet se janë kryer ndryshime, ku për vitin 2023 janë akorduar fonde në shumën 61,900 mijë lekë, ku 16,862 mijë lekë janë paga dhe sigurime shoqërore, 43,879 mijë lekë janë shtesa për detyrime të papaguara të vitit paraardhës dhe 1,159 mijë lekë janë shtesa për fonde rindërtimi, këto shifra tregojnë qartë për planifikime optimiste, të cilat gjatë

vitet ushtrimor nxisin shkurtimeve e shpenzimeve ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

➤ **Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Kurbin, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Kurbin, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2023, të miratuar me VKB ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara nga auditimi i shkresave, evidencave të celjeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Kurbin u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Tabela nr.6, Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	2023		
		Plan	Fakt	Realizimi në %
1	Paga 600	333,776	290,719	87
2	Sigurime shoqërore 601	54,070	49,692	92
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	257,527	169,761	66
4	Transferime 604 (Kësh.Qarkut, Reload, Sporti)	1,949,015	924,019	47
5	Nd/Ekonom invalid 606.609	620,844	605,622	98
6	Investime (230/231)	192,088	132,212	69
7	Mjete ne ruajtje 466		11,891	
	Totali	3,407,319	2,183,915	64

000/lekë

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2023** janë realizuar 2,183,915 mijë lekë nga 3,407,319 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 64%.

Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Kurbin. Në këtë masë realizim ka ndikuar realizimi në masë të ulët në zërat e buxhetit:

a. Transferime llog. 604 (Këshilli i Qarkut, Sporti, Emergj civile) janë realizuar në masën 47%.

b. Fondet e rindërtimit llog. 604 janë realizuar në masën 47%.

c. Shpenzimet operative llog. 602 janë realizuar në masën 66%.

d. Shpenzimet për investime llog. 231 janë realizuar në masën 69%.

Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë transferimet llog. 604/ Fondet e Rindërtimit ndjekur nga llog. 606 /transferime tek individët për ndihmë ekonomike e invaliditeti dhe shpenzimet për paga personeli.

Tabela nr.7, Tregues e buxhetit që zënë peshën specifike. (në %):

Nr.	EMËRTIMI	Përqindja ndaj totalit
		Viti 2023
1.	Transferime (602, 604, 606, 609)	70.3
2.	Investime	69
3.	Shpenzime për paga	89.5

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

Fondi rezervë për vitin 2023 është në total në shumën 3,000 mijë lekë, i cili është miratuar që nga buxheti fillestar dhe deri në fund të vitit buxhetor është bërë 6,630 mijë lekë.

- Miratimi fillestar me VKB nr. 106 datë 21.12.2022 në vlerën 3,000 mijë lekë.

Përdorimi i Fondit Rezervë në vlerën 4,077 mijë lekë.

Janë përdorur për paga dhe sigurime 339,298 mijë lekë, transferta për individë 1,526,676 mijë lekë dhe shpenzime operative 169,761 mijë lekë dhe investime 132,212 mijë lekë.

- Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2023, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6. Për vitin 2023 është dërguar “Raport monitorimi i Buxhetit Janar – Prill” me shkresën nr. 2583.prot., datë 25.05.2023, “Raport monitorimi i Buxhetit Janar – Gusht” me shkresën nr. 4360 prot., datë 28.09.2023, “Raport monitorimi i Buxhetit Janar – Dhjetor” me shkresën nr. 1029 prot., datë 27.02.2024. Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizimit të të ardhurave

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, që mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

- Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara

Me fondet e vitit buxhetor 2023, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës apo FZSHH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Tabela nr.8, Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602	Vendime gjyqësore	Llog. 230-231
Viti 2023	55,981	55,981		45,787	3,972	6,222

Burimi: Drejtoria e Financës.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Tabela nr.9, Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2023:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2022	Detyrimi i krijuar në periudhën 01/01/2023 - 31.12.2023	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2023	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023
	1	2			
a. Investime nga Ministrinë e linjës e FZSHH					
b. Investime nga Bashkia	58,651		58,651	52,429	6,222

000/lekë

INVESTIME:					
Mallra dhe shërbime	48,217	4,638	52,855	7,068	45,787
Paga dhe Sigurime	2,688		2,688	2,688	
Vendime gjyqësore	3,477	1,204	4,681	709	3,972
Totali:	113,033	5,842	118,875	62,894	55,981

Burimi: Drejtoria e Financës.

Bashkia Kurbin ka dërguar në MFE e për rrjedhojë dhe publikimit të detyrimeve të prapambetura në faqen e MFE në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 113,033 mijë lekë dhe në fund të vitit 2023, referuar shkresës nr. 1028 prot., datë 27.02.2024 “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura” në shumën 55,981 mijë lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar 5,842 mijë lekë, por njëkohësisht është likujduar vlera prej 62,894 mijë lekë, vihet re që detyrimet e prapambetura na paraqiten në rënie në shumën prej 55,981 mijë lekë. Referuar shkresës nr. 1028 prot., datë 27.02.2024 “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura”.

Tabela nr.10, Detyrimet e prapambetura janë të rakoduara me Degën e Thesarit.

Llogaria ekonomike	Përshkrimi	Gjendje me 31.12.2023	Thesari
4864100	Vendime gjyqësore	3,972	3,972
4864200	Sherbime	9,761	9,761
4864300	Mirembajtje		
4864400	Investime	6,222	6,222
4864500	Rimbursim TVSH		
4864600	Mallra		
4864601	Sig.shoqerore		
4864602	Sig.shendetesore		
4864603	Te ardhura personale		
4864604	Tatime te tjera		
4864900	Te tjera		
4864903	Transferta te individ		
4864201	Energji elektrike	36,026	36,026
		55,981	55,981

Burimi: Drejtoria e Financës.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2023 Bashkia Kurbin ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 55,981 mijë lekë, e cila ka ardhur duke u rritur. Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2023 rezultoi se është bërë planifikimi i fondeve të vecuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Tabela nr.10, Detyrimet e prapambetura për vitin 2023 të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 1028 prot., datë 27.02.2024, jepen në tabelën si më poshtë:

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	55,981		693
Llog.ekonomike	Emertimi	55,981		
4864100	Vendime gjyqësore	3,972		
4864200	Detyrime të prapambetura shërbime	9,761		
4864201	Detyrime të prapambetura energji elektrike	36,026		
4864300	Detyrime të prapambetura mirëmbajtje	0		
4864400	Detyrime të prapambetura investime	6,222		
4864600	Detyrime të prapambetura mallra	0		

000/lekë

III	Totali (I+II)	55,981	807,558	6.93
-----	----------------------	---------------	----------------	-------------

Burimi: Drejtoria e Financës.

✓ Situatë normale e gjendjes Financiare.

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën 55,981 mijë lekë dhe fondet faktike për shpenzime të këtij viti janë në vlerën 807,558 mijë lekë (3,407,319 mijë lekë totali i planifikuar-679,287 mijë lekë transferta e kushtëzuar ndihmë ekonomike & invaliditetet -1,920,474 Fondet e rindërtimit). Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 6.93 % kundrejt fondeve të miratuara. Kjo situatë tregon se, Bashkia Kurbin është në situatë normale të gjendjes financiare në fund të vitit ushtrimor 2023, pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 15%, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

• Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta (minimale) të Bashkisë Kurbin.

-Për **vitin 2023** janë planifikuar fonde për investime në shumën **192,088 mijë lekë** (nga të cilat 136,298 mijë lekë janë nga granti i pakushtëzuar + të ardhura dhe 55,790 mijë lekë transfertë e kushtëzuar M.linje), realizuar dhe likuaduar në vitin 2023 në vlerën 132,212 mijë lekë. Realizimi në masën 69 % i investimeve ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve si mos realizimi i të ardhurave.

Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime, të cilat janë shqyrtuar nga GMS, i cili ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me VKB për secilin rast.

Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në kapitullin Anekse, tabela nr.30:

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e investimeve në nivel projekti paraqiten si më poshtë: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 22 projekteve të investimeve Bashkia Kurbin, rezultoi se janë realizuar dhe finalizuar me kontratë 12 projekte.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 12 projekteve të investimeve Bashkia Kurbin, rezultoi se janë ndjekur hapat: Për çdo procedurë prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Kurbin. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Kurbin dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Kontrata është regjistruar e plotë me qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëzuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit.

➤ Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Tabela nr.11, Realizimi i buxhetit për vitin 2023 sipas burimit të financimit

Nr	Emertimi	2023		
		Plan	Fakt	Real. Në %
1	Paga 600	333,776	290,719	87
	grant I kushtëzuar	9,600	9,116	95
	grant I pakushtëzuar + tarsnsferta sektoriale	274,536	260,076	95
	te ardhura	49,640	21,527	43
2	Sigurime shoqërore 601	54,069	49,691	92
	grant i kushtëzuar	950	916	96
	grant I pakushtëzuar + tarsnsferta specifike	45,161	43,780	97
	te ardhura	7,958	4,995	63
3	Shpenz.operative 602+ F.rezerve 606	257,527	169,761	66
	grant I kushtëzuar	2,317	1,695	73

	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	188,964	126,049	67
	te ardhura	66,246	42,017	63
4	K.Qarkut Transferime 604, + F.Rindertimit ,+ 609	1,959,031	924,019	47
	grant I kushtezuar	6,807	6,749	99
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	1,949,524	917,266	47
	te ardhura	2,700	4	0
5	Nd Ek, invalid 606 ,bonus strehimi ,Ndhima Financ	610,828	605,622	99
	grant I kushtezuar	603,823	601,171	100
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	7,005	4,451	64
	te ardhura	0	0	0
6	Investime 230-231	192,088	132,212	69
	grant I kushtezuar	55,790	55,789	100
	grant I pakushtezuar + trasnsferta specifike	86,712	46,437	54
	te ardhura	49,586	29,986	60
	Totali Bashkia Kurbin	3,407,319	2,172,024	64

Burimi: Drejtoria e Financës.

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” për vitin 2023 në masën 7 %
- Shpenzimet në artikullin 601 “kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” për vitin 2023 në masën 10 %.
- Shpenzimet në artikullin 602 “shpenzime operative për mallra e shërbime” për vitin 2023 në masën 25 %.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “investime” për vitin 2023 në masën 23%.
- Shpenzimet në artikullin 604 “transferime “ për vitin 2023 në masën 0%.

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2023** shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 98,530 mijë lekë ose në masën 5%, nga transferta e pakushtezuar dhe transferta specifike në shumën 1,398,058 mijë lekë ose në masën 64%, nga transferta e kushtezuar në shumën 675,436 mijë lekë ose në masën 31%.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III.2.3. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të pikës II.3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023*
- *Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2023.*
- *Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.*
- *Rakordimet me agjentët tatimor.*
- *Evidenca e planifikimit të të ardhurave.*
- *Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.*
- *Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.*
- *Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.*

Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

-Dokumentacioni i shqyrtuar për auditimin e të ardhurave.

Në auditimin e kryer mbi burimin e krijimit të ardhurave dhe përdorimi i tyre u audituan dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e planifikimit të ardhurave si: Evidencat analitike të llogarive debitorë për taksat dhe tarifatat vendore, akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore, evidencat mbi gjendjen e debitorëve për

taksat dhe tarifate vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve, administrimi i aseteve, procedura e lëshimit të liçencave dhe autorizimeve, si dhe dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifate vendore, Vendimet e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale dhe për strukturën organike.

-Baza ligjore

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKB-në nr. 91, datë 18.11.2022, konfirmuar dhe nga Prefekti i Qarkut Lezhë, “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kurbin” ku përfshin dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 "Për Prcedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar. Përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, u auditua dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2023.

-Struktura e Drejtorisë të Ardhurave Bashkia Kurbin (DAV).

Për vitin 2023 me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr.104, datë 21.12.2022 është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Lezhë me nr. 967/4 prot., datë 30.12.2022. Me vendim të Kryetares së Bashkisë nr.2, me nr. 95 prot., datë 09.01.2023 është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sectorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe Drejtoria e të Ardhurave, si më poshtë vijon:

-Drejtoria e të Ardhurave Vendore (*këtu e vijim DAV Bashkia Kurbin*), ka në strukturën e saj **23 punonjës** ndarë konkretisht, 1 (një) Drejtor, 1 (një) Përgjegjës i Sektorit 1 (një) specialistë për menaxhimin e taksave dhe tarifave familjarëve, 2 (dy) specialiste regjistri, 1 (një) specialistë kontabiliteti, 1 (një) specialistë transporti dhe 1 (një) përgjegjës sektori i inspektorëve të terrenit, 15 (pesëmbëdhjetë) specialistë inspektimi në terren nga të cilët 2 inspektor terreni dhe 1 specialistë i transportit janë larguar përgjatë vitit 2023, paraqitur në kapitullin Anekse, tabela 35.

Për vitin 2023, pranë Bashkisë Kurbin ka funksionuar Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave, struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Kurbin nga taksat dhe tarifate. Kjo drejtori në aktivitetin e saj për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave duhet të bashkëpunojë edhe me drejtori/sector të tjerë pranë bashkisë, si ai i pronave, urbanistikës, infrastrukturës, shërbimeve ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit/faturës për arkëtim/sipas rastit ndjekja e arkëtimin, si dhe roli i DAV është kryesisht në hartimin dhe përditësimin e regjistrat të taksave dhe tarifave vendore, ndjekjen e arkëtimin/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

-Taksat dhe Tarifate e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Kurbin.

Për vitin 2023, paketa fiskale e Bashkisë Kurbin është miratuar me VKB nr. 91 datë 18.11.2022, me nr. 6027/3 prot., datë 21.11.2022, “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2023”, si dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me nr. 860/2 prot., datë 02.12.2022. Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme Bashkia Kurbin krijon të ardhura nga këto burime: Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore, taksa mbi truallin, taksa për tabelat dhe reklamat, taksa e biznesit privat taksa të tjera, tarifa për shërbime administrative, tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave, tarifa të shërbimeve publike vendore (mbetje, gjelbërim etj.).

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023 sipas planit ka qenë 156,676 mijë lekë.

Për vitin 2023, ka pasur realizim të planit të përgjithshëm të ardhurave në masën 65% ose 101,089 mijë lekë si dhe një mosrealizim në masën 35% ose në vlerën 55,587 mijë lekë, të

rakorduara me thesarin. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2023, referuar akt-rakordimve me degën e Thesarit Kurbin paraqitet në tabelën e mëposhtëme.

-Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas llojeve të taksave, tarifave dhe të ardhurave të tjera.

Tabela nr.12, Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave – viti 2023

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2023		
		Plan	Fakt	%
a	b	1	2	3
I	Të ardhura nga Tatimet	500	329	66
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	500	329	66
II	Të ardhura nga Taksat	90,356	52,341	58
2	Taksa e Pasurisë, Ndërtesë	13,441	4,687	35
3	Taksa mbi tokën Bujqësore	19,369	341	2
4	Taksë mbi regjist. e Automjeteve	31,000	38,181	123
5	Taksa e ndik të nd mbi infrast	24,300	7,481	39
6	Taksë Tabele	534	349	65
7	Taksë Hoteli	0	0	0
8	Taksë Parkimi	190	139	73
9	Taksë për hapësira publike	0	0	0
10	Taksë Reklame	1,522	1,163	76
III	Të ardhura nga Tarifat	27,927	12,901	46
11	Tarifë Pastrimi	18,101	8,129	45
12	Tarifë shërbim te tjera publike	3,418	1,281	37
13	Tarifë leje transport.	1,696	1,333	79
14	Tarifë vend banor/gj CIVILE	0	0	0
15	Tarifë Urbanistike etj.	200	575	288
16	Tarifë regj biznes i Ri etj.	630	35	6
17	Tarifë ndriçimi rrugor	3,882	1,548	40
18	Të ardhura të tjera	0	0	0
19	Tarifë certifikimin mishi	0	0	0
IV	Të ardhura të tjera	37,893	35,518	94
20	Qira trualli	0	0	0
21	Shitje Pase & privatiz banese	200	69	35
22	Qira kullote	1,465	0	0
23	Gjoba.	12,011	6,674	56
24	Taksë Vule	0	0	0
25	Qira ndërtesë	0	0	0
26	Dhurata, sponsoi & Garanci.	0	2,847	
27	Të ardhura të tjera	24,217	25,928	107
	GJITHSEJ (I+II+III+ IV)	156,676	101,089	65

Burimi: DAV Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2023, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 156,676 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 101,089 mijë lekë ose 65 % më pak se planifikimi. Në këto mos realizime të vitit 2023 të analizuar në nivel taksash dhe tarifash kanë ndikuar mos realizimi i:

- Taksa e pasurisë, Ndërtesë realizimi i secilës është në vlera të ulëta, ku për vitin 2023 është në masën 35%.
- Shitje pasurie dhe privatizim banese, realizimi i secilës është në vlera të ulëta, ku për vitin 2023 është në masën 35%.
- Tarifë ndriçimi rrugor, realizimi i secilës është në vlera të ulëta, ku për vitin 2023 është në masën 40%.
- Tarifë shërbim të tjera publike, realizimi i secilës është në vlera të ulëta, ku për vitin 2023 është në masën 37%.
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, ndertimet e reja, dhe ato në proces legalizimi, është realizuar në masën 39%. Mosrealizimi në 61% i taksës së ndikimit në infrastrukturë është së bashku me legalizimet dhe taksa për ndërtimet e reja. Për legalizimet janë njoftuar zyrtarisht qytetarët për çdo dosje të ardhur nga ASHK, Lezhë për të bërë pagesën. Rezulton se nga ZVRPP sot ASHK nuk janë bllokuar dosjet deri në pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Kurbin. Për këtë arsye nga zyra e Tatim Taksave u janë dërguar të gjithë subjekteve debitorë të identifikuar, njoftime për pagesë. Janë afishuar listat emërore të personave debitorë, pranë Bashkisë Kurbin. Janë dërguar lista emerore tek Agjensia

Shtetërore e Kadastrës Kurbin etj, për ti vënë në dijeni lidhur me detyrimin me qëllim arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Taksa për ndërtesat e legalizuara ndër vite, nuk është realizuar pasi ASHK ka pajisur me dokumentacion pronarët e tyre pa u paguar kjo taksë në Bashki.

- Taksa e tokës bujqësore, është realizuar vetëm në masën 2 % të planit të parashikuar, me mos realizim në masën 98%. Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore haset vështirësi në vjeljen e taksës së tokës bujqësore ndaj fermerëve për shkak të konflikteve të pronësisë ndërmjet familjeve që pretendojnë mbi pronën e tyre dhe mos organizimit të duhur të punës për vjeljen e taksës. Kjo sjell të ardhura të munguara nga viti në vit në buxhetin e Bashkisë.
- Taksa e tabelës, është realizuar në masën 65% e planit.
- Tarifa e pastrimit, është realizuar në masën 45%. Kjo tarifë sipas paketës fiskale për Njësitë Administrative ka ndryshim tarife nga qyteti. Realizimi në këtë masë ka ardhur nga institucionet dhe bizneset por jo nga familjarët.
- Tarifë për leje transporti, është realizuar në masën 79% e planit, për subjektet e transportit që pajisen nga Bashkia me licensë e certifikatë transporti.
- Tarifë parkimi, është realizuar në masën 73 %.
- Tarifa për zënien e hapësirave publike, nuk është realizuar.
- Gjoha, (interesa, kamatë vonesat) janë realizuar në masën 56 % e planit.

Përsa i përket përdorimit të ardhurave, janë përdorur sipas planifikimit buxhetor, ndërsa pjesa e papërdorur është mbartur në buxhetin e vitit pasardhës.

Nga auditimi konstatohet se, ekzistojnë disa zëra për të cilat Drejtoria e të Ardhurave nuk ka bërë planifikim për vitin 2023. Përkatësisht, zërat e të ardhurave nga qiratë për tokën, qira për troje, qira për ndërtesat, të ardhura nga ndërmarrjet e tjera (shitje e asetëve) etj., Taksë e zënies së hapësirës publike, taksa për fjetjen në hotel, etj., këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 91, datë 18.11.2022 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kurbin për vitin 2023”, VKB nr. 106, datë 21.12.2022, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023”.

-Evidentimi dhe mbajtja e regjistrit të tatimpaguesve

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për qytetin dhe çdo njësi administrative është krijuar në mënyrë elektronike regjistri për taksat dhe tarifave vendore për subjektet private dhe familjarët, njësitë administrative (Laç, Milot, Mamurras, Fushë Kuqe si dhe për Bashkinë Kurbin, si më poshtë:

Për subjektet private në qytet dhe në Njësitë Administrative, administrohen nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në format excel. Nuk ka një program të vecantë lidhur me mbajtjen e tyre. Për bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë dhe në Njësitë Administrative funksionon sistemi i taksave sipas llojit (Biznes i madh dhe Biznes i vogël) ndërtesa me qira, ambulante). Për familjarët në 4 Njësitë Administrative përdoret regjistri i kodifikuar i tatimpaguesve në format excel. Eshhtë marrë informacioni zyrtarisht nga gjendja civile për Bashkinë Kurbin dhe Njësitë Administrative, ku bazuar këtij regjistri janë parashikuar dhe tarifave e familjeve sipas paketës fiskale. Regjistri Elektronik për familjarët në qytet dhe në 4 Njësitë Administrative mbahet në formatin Excel (ndërtesë, truall, tokë bujqësore, etj), në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

-Gjendja apo statusi i subjekteve privat tatimpagues

Për vitin 2023 numri i subjekteve në fund të vitit është 1,176. Subjekte të reja për vitin 2023 janë 31. Subjekte të mbyllura/pezulluara në vitin 2023 janë 50.

Nr. i bizneseve, shtuar dhe pakësuar gjatë periudhës dhe gjendja në fund të vitit 2023 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.13, Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

Lloji i Biznesit	Paraqitja e numrit të bizneseve per vitin 2022				
	Gjendja fillim 01.01.2023	Biznese të reja gjatë vitit 2023	Biznese mbyllura/pezull gjatë vitit 2023	Gjendja në fund të vitit 2023	Biznese të pa regjistruar deri në fund të vitit 2023
B. Madh	223	5	26	202	
B. Vogël	919	26	24	921	
Ambulant	34			34	
Institucione	19			19	
Gjithsej	1195	31	50	1176	

Burimi: DAV Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Kategoria “Biznes” dhe “Institucione”.

Debitorët “Biznes” dhe “Institucione” të cilët nuk kanë likujduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

Tabela nr.14, Debitor kategoria “biznes”

000/lekë

Njësia Administrative	Në fund të vitit 2022		Krijuar brenda vitit 2023			Likujduar 2023	Në fund të vitit 2023
	Nr	Vlerë Totale	Nr	Vlera	Kamatvonesë		
B.Vogël							
Qendër (Laç)	283	19,999	317	4,176	601	1,299	27,326
Milot	36	1,897	39	521	75	171	3,124
Mamurras	84	3,465	92	1,238	178	772	5,835
Fushë-Kuqe	35	2,863	30	508	73	1,460	1,718
B.Madh							
Qendër (Laç)	12	8,491	21	1,433	206	2,498	11,744
Milot	18	8,280	24	2,115	289		13,484
Mamurras	15	5,869	14	614	88	1,041	9,463
Fushë-Kuqe	4	358	2	114	16	328	166
TOTAL (B.M+B.V)	487	52,727	539	10,719	1,528	7,571	57,405

Burimi: DAV Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga DAV, rezulton se në fund të vitit 2022 kanë qenë debitor 487 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 51,222 mijë lekë dhe 14 institucione në vlerën 1,505 mijë lekë.

-Në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 539 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 55,447 mijë lekë, përfshirë edhe kamatvonesat dhe 14 institucione në vlerën **1,958 mijë lekë**, pra gjithsej **57,405 mijë lekë** për **539** subjekte dhe 14 institucione, të cilat janë kontabilizuar dhe përbëjnë të ardhura të pa arkëtuara, për buxhetin e Bashkisë Kurbin.

-Në fund të vitit 2023 në krahasim me fillimin e vitit 2023, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje. Konkretisht në fillim të vitit 2023 janë debitor 487 subjekte për vlerën 52,727 mijë lekë, ndërkohë në fund të vitit 2023, janë 539 subjekte në vlerën 57,405 mijë lekë. Konkretisht gjatë vitit 2023 janë krijuar 52 subjekte debitorë për vlerën 4,678 mijë lekë.

-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga DAV Bashkia Kurbin, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, u konstatua se bashkëpunimi me policinë bashkiake ka qenë normal dhe i vazhdueshëm, për shpërndarjen e njoftimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat në territorin e Bashkisë Kurbin. Ndaj subjekteve debitorë nuk është vazhduar me masa shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokimi i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 76, neni 114 dhe neni 117 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

Neni 64 në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

-Taksa e tokës bujqësore.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Agjensia e administrimit të pyjeve dhe kullotave, Bashkia Kurbin rezulton se numri i familjeve të trajtuara me tokë është 7.497 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 9537 Ha, sipërfaqe e ndarë me AMTP. Kjo sipërfaqe duhet të shërbejë për Bashkinë Kurbin për planifikimin e taksës së tokës bujqësore. Ndarja e tokës bujqësore me AMTP, sipas Njësive Administrative të Bashkisë Kurbin, pasqyrohet si më poshtë:

Tabela nr.15

Njësiti Administrative	Nr. i fshatrave për çdo njësi	Sipërfaqja e tokës së ndarë në (Ha)	Nr. i familjevetë trajtuara me tokë sipas ligjit 7501
Lac	2	1380	959
Mamurras	7	3783	2949
Milot	13	1796	2118
Fushë Kuqe	5	2578	1471
SHUMA	27	9537	7497

Burimi: DAV Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Planifikimi i taksës së tokës është bërë në bazë të dhënash për bazën e taksueshme të sipërfaqes së tokave bujqësore në disponim të familjeve fermere, informacion i cili i dërgohet nga Njësiti Administrative Drejtorisë të Ardhurave në fazën e përgatitjes së buxhetit. Planifikimi i të ardhurave sipas Bashkisë Kurbin për vitin 2023 i taksës së tokës bujqësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.16, Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kurbin

Kategoria e tokës	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Sip/HA	Vlera/Ha	Plani/Lekë
	Nj.A. Lac	Nj.A. Mamurras	Nj.A. Milot	Nj.A. FushëKuje		
Kategoria II	1380				1380	3,381,000
Kategoria III		3783	1796	2578	8157	15,987,720
Totali sip. Ha sipas planifikimit familjet rezidente						

Burimi: DAV Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës rezulton se: Nga Njësiti Administrative disponohen regjistrat e tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere. Mbi bazën e këtyre regjistrave të hartuar në vitet e mëparshme nga të dhënat e marra nga sektori i Bujqësisë nga specialistët e taksave ngarkoheshin familjet fermerë me taksën e tokës sipas kategorisë dhe nivelin e taksës përkatëse të përcaktuar në paketën fiskale.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet ecuria e ditorëve familjar për taksën e tokës bujqësore.

Tabela nr.17, Debitor për taksën e tokës bujqësore

000/lekë

Debitor toka bujqësore 2023						
Njësiti administrative	Debitor të trashëguar deri në fillim të vitit 2023 (2011-2022)	Debitorë krijuar në vitin 2023 (Lekë)			Likujduar	Debia Progressive
		Familje me tokë bujqësore	Familje debitore (Nr)	Familje debitore 2023		
LAC	23,204	959	920	3,126		
MAMURRAS	42,181	3163	3134	8,057		
MILOT	21,911	3029	2961	3,384		
FUSHË-KUQE	24,827	1716	1714	4,800		
TOTALI	112,125	8,867	8,729	19,369	341	131,152

Burimi: DAV Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive vlera debitore është 112,125 mijë lekë dhe në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive janë 8.729 familje debitore për vlerën

131,152 mijë lekë, nga të cilat, në vitin 2023 është krijuar 19,027 mijë lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2022, në fund të vitit 2023 kemi rritje të vlerës debitoare për taksën e tokës bujqësore, ç'ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kurbin në arkëtimin e kësaj takse.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Pika 2 në nenin 89 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pika I.2.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kurbin për vitin 2023.

Masat shtrënguese për arkëtimin e borxhit

Për vitin 2023 ka ecuri lidhur me masat shtënguese por gjithsesi në nivele të ulëta vendosje apo ekzekutimi. Masat shtrënguese nuk janë ezauruar të plota sipas përcaktimeve ligjore. Nuk është kryer një analizë e detajuar për secilin nga këta debitor tatimpagues për nxjerrë shkaku e mos mbledhjeve të detyrimeve. Analiza dhe planet operationale janë një hap i cili duhej dhe duhet të jetë në të ardhmen në fokus si indikator orientues për vijimin e marrjes së masave me qëllim arkëtimin e detyrimeve për secilin debitor, biznes i madh i vogël apo cdo lloj debitori. Trendi i rritjes së detyrimeve të pa paguara mbetet akoma i lartë dhe për pasojë ka sjellë të ardhura të munguara, të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhetin e Bashkisë Kurbin, të ardhura këto që mund të përdoshin nga Bashkia për investime në infrastrukturë dhe rritjen e përmirësimit të shërbimeve e në tërësi përmirësimin e kushteve të qytetarëve të kësaj bashkie.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit dhe praktikave të ndjekura për mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e arkëtimin e borxhit u konstatua se administrimi i procesit për mbledhjen e detyrimeve tatimore ka mangësi në lidhje me ndjekjen e veprimeve proceduriale nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Ardhurave Vendore, duke mos ezauruar në kohë dhe me efikasitet të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në ligjislacionin tatimor për të siguruar mbledhjen e këtyre detyrimeve.

Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga bizneset nga kjo drejtori dhe sidomos nga specialistët dhe inspektorët e taksave në Njësitë Administrative, janë mjaftuar vetëm më dërgimin e njoftim detyrimeve për subjektet debitorë. Nuk kanë vazhduar më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) apo për vendosjen e barrës së pasurisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Gjithashtu nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese për debitorët si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve si dhe deri në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar” nenet 89-91.

Agjentët tatimorë

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj, janë regjistruar në evidencat përkatëse, pavarësisht se nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga ASHK-ja derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Kurbin brenda datës 5 të çdo muaji. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Kurbin janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.18, Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Kurbin, për vitin 2023

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	Plan	000/lekë	
			Fakti	
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	500	329	

D.R.SH.T rrugor	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	31,000	38,181
Z.V.R.P.P (ASHK)	Taksa e kalimit të pronësisë	0	69
DPT & DPD	Renta Minerare	0	66
Ujësjiellës-Kanalizime	Taksë ndërtese		0
	Tarifë shërbimi		0
TOTALI		31,500	38,645

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të ulët realizimi.

Bashkia Kurbin nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.

Mbi tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Kurbin.

-Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kurbin mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, në zbatim të legjislacionit në fuqi:

- Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligj nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;
- VKM nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”;
- Referuar të dhënave nga databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, (institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve).

Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësisive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifatat vendore janë *pasqyruar në kapitullin Anekse, tabela nr.2, “Lista e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure”, bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.*

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, sa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, rezulton se Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Kurbin, përgjatë vitit 2023 ka nxjerrë urdhër bllokimi të llogarive bankare të subjekteve debitore si dhe i është drejtuar me shkresë subjekteve për pajisjen me licencën/autorizim për ushtrimin e aktivitetit.

- Pra sa më sipër konstatohet se gjatë vitit 2023, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

- Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mosmarrjes së masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (përgjatë vitit 2023) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 16 subjekte për 16 stacione shitje të karburantit nuk kanë kryer pagesën e tarifës së licensimit dhe për pasojë janë krijuar të *ardhura të pa arkëtuara në buxhetin e Bashkisë Kurbin në vlerën 17,400,000 lekë, të cilat janë kontabilizuar, pasqyryar në kapitullin Anekse, tabela nr. 34.*

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 4 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.

Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “*...nuk i paguan ato në buxhet*” të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë (DVASHK), u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën e vitit 2023, i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Kurbin deri në 31.12.2023, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar lejet e legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të bashkisë Kurbin. Nga DVASHK Lezhë, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësi Administrative të bashkisë Kurbin, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Kurbin, nuk janë marrë masa të veçanta për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga DVASHK Lezhë. Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën deri më 31.12.2023.

Tabela nr.19, TNI për legalizimin e objekteve informale - Viti 2023

Debitor TNI	Subjekte	Vlera/000/L
Gjithsej progresive	1485	50,742
Nga të cilat në 2023	222	7,871
Nga të cilat progresive deri në 31.12.2022	1263	42,871

Burimi: Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Kurbin u konstatua se, nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi nga DVASHK Lezhë konkretisht:

- Vlera debitore progresive është 50,742 mijë lekë për 1485 subjekte (nga të cilat 222 subjekte për vlerën 7,871 mijë lekë krijuar në vitin 2023), të cilat janë kontabilizuar.

Për arkëtimin e vlerës debitore krijuar si rrjedhojë e mos likuidimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale, nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, si dhe ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Kurbin, për shkëmbimin e informacionit si dhe ndjekjen e procedurave ligjore nga sektori i mbledhjes së borxhit, për arkëtimin e TNI.

Këto veprime janë në kundërshtim me Paketën Fiskale 2023, pika IV. 5.3. Pika 2 në nenin 89 në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 22/5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar.

-Toka bujqësore dhe pyjore e dhënë me qira.

Për auditimin e kontratave të qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Kurbin dhe subjekteve juridik/fizik, saktësinë e tarifave të aplikuara dhe arkëtimin e tyre, të cilat e shtrijnë efektin e tyre deri më datë 31.12.2023, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligji nr.57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;
- VKM nr.54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;

Nga të dhënat e Agjensisë së administrimit të pyejeve dhe kullotave, Bashkia Kurbin, konstatohet se janë lidhur 1 kontratë për vendosje antene dhe 2 kontrata për HEC.

- Kontratat e lidhura me subjektet juridike/fizike për përdorim të fondit pyjor/kullor/tokës bujqësore, banesave sociale, dyqaneve, pasqyruar si më poshtë:

Tabela nr. 20

000/lekë

Nr.	Qiramaresi	Zona	Objekti	Afati Vjet	Kontrate	Debia progresive 31.12.2022	Detyrim vjetor	Kamat vones	Paguat Përgjatë vitit 2024	Detyrimi
					Nr., Datë					
1	H P C	Vinjollë	HEC	10	Dt.10.03.2014	1,465	699	66	2,232	0
2	H P C	Vinjollë	HEC	9	Dt.15.02.2014	406	376	37	1,204	0
3	O T	Lac	ANTENE	9	Nr.5075 Prot, Dt.29.09.2022	0	352	21	373	0
	Total					1,871	1,428	125	3,424	0

Burimi; Agjensia e administrimit të pyejeve dhe kullotave, Bashkia Kurbin

Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për asetet, që Bashkia Kurbin ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur gjithsej 3 kontrata qiraje për objekte dhe truell në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 1,428 mijë lekë.

Në fund të vitit 2022 progresive ka mbetur pa u likujduar vlera 2,255 mijë lekë nga subjekti “H P C” për 2 kontrata qiraje për Hece.

Përgjatë vitit 2024 subjekti i mësipërm për 2 kontratat e qirasë ka likujduar vlerën debitore 2,255 mijë lekë si dhe detyrimin e vitit 2023 bashkë me kamatvonesat në vlerën 1,180 mijë lekë, pra në fund të vitit 2023 progresive nuk ka mbetur asnjë vlerë debitore nga 3 kontratat e qirasë.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicionit është konstatuar se 2 kontratat e qirasë datë 15.02.2014 e lidhur ndërmjet Drejtorisë Shërbimit Pyjor Laç përfaqësuar nga ish Drejtori z. A. N dhe subjektit H C Shpk me Administrator z. K. L rezulton se, afati i kontratës së sipërcituar ka mbaruar më datë 15.02.2023 si dhe kontrata e qirasë datë 10.03.2014 e lidhur ndërmjet ish Komunës Milot përfaqësuar nga ish kryetari i Komunës z. B. H dhe subjekti H C Shpk me Administrator z. F. L rezulton se, afati i kontratës së sipërcituar ka mbaruar më datë 10.03.2024, pra kontratat e mësipërme nuk janë rinovuar. Nga Drejtoria Juridike e Bashkisë Kurbin i është kërkuar subjektit të mësipërm që të paraqitet pranë Bashkisë për të rinovuar kontratat ose në të kundërt të lirohet hapsira e cila është zënë nga qiramarrësi.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 3 të kontratës së qirasë.

Debitor nga gjoba të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit kryqëzuar me informacionin e pasqyruar në akt-rakordimin për të ardhurat dhe pasqyrat financiare të vitit 2023, të cilat janë në formë të prerë dhe që nuk pengohet ekzekutimi i tyre, janë gjithsej 63 subjekte të gjobitura për vlerën 50,960 mijë lekë lekë, të kontabilizuara por të pa arkëtuara, nga të cilat 44 gjoba në vlerën 40,334 mijë lekë janë deri në 31.12.2022 dhe 19 subjekte të gjobitura për vlerën 10,626 mijë lekë janë krijuar përgjatë vitit 2023. *Pasqyruar në tabelën përmbledhëse si më poshtë dhe në kapitullin Anekse, tabela nr.33, analitike:*

Tabela nr.21, Gjodat e IMTV Bashkia Kurbin

000/lekë

Debitor IMTV deri në 31.12.2023	Subjekte	Principal	Paguar	Kamatvonesë	Gjithsej
Nga të cilat deri 31.12.2022	44	40,334			40,334
Nga të cilat krijuar në 2023	19	11,165	539		10,626
Nga të cilat progresive deri në 31.12.2023	63	45,017	539		50,960

Burimi: DAV Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konstatohet se gjodat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nga Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit nuk është bërë kërkesë për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit të tyre, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Për realizimin e të ardhurave nga tarifatat vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kurbin.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kurbin, mbi arkëtimin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në Bashkinë Kurbin, si dhe për subjekte të cilat kanë kryer punime ndërtimi si rrjedhojë e lejeve të ndërtimit të dhëna për subjekte të ndryshme, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Paketa fiskale e vitit 2023;
- Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2023 - 31.12.2023;
- Leje ndërtimi, njoftim i fillimit të punimeve dhe certifikatë përdorimi;
- Faturimi i detyrimit dhe pagesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1. Përshkrimi i situatës.

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura, u auditua dokumentacioni për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Kurbin) ku rezultoi se përgjatë vitit 2023 (përfshirë edhe subjekte të cilat kanë nisur punimet në vitin 2022, por kanë përfunduar në vitin 2023) kanë kryer punime ndërtimi gjithsej 14 subjekte, të cilët nuk janë pajisur me NIPT sekondar e për rrjedhojë nuk janë taksuar për tarifën e pastrimit dhe shërbimit, pasqyruar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 22 Subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Kurbin

Viti 2023					
Nr.	Objekti i Prokurimit/Leja e Ndërtimit	OE/Subjekti ndërtues	NIPT	Tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit	Detyrimi
				(Lekë)	(Lekë)
1	“Rehabilitim i rrugës Miloti, Mal Milot, Bashkia Kurbin”	OE “S” Shpk	J.....M	12,300	12,300
2	“Sistemim, asfaltim rruga e fushës, Gjorem (Loti I), (km00+000 – km01+000), Bashkia Kurbin”	OE “B” SHPK	J.....M	12,300	12,300
3	“Rikonstruksion i rrugës, Lagje Nr.2 Laç, Bashkia Kurbin”	OE “S.M.O. U” Shpk	J.....Q	12,300	12,300
4	“Rindërtimi në truallin ekzistues të 3 (tre) njësisve të banimit (Pallate), pallati nr.1 Laç (Poligoni), pallati nr.2 dhe nr.3 Mamurras, Bashkia Kurbin, në kuadër të procesit të rindërtimit”	OE “4 A-M” Shpk	K.....L	98,656	98,656
5	“Blerje mobilieri për godinën e Bashkisë Kurbin”	OE “M” Shpk	K.....H	6,166	6,166
6	“Rindërtimi dhe rikonstruksioni i 5 (pesë) qendrave shëndetësore në Bashkinë Kurbin, në kuadër të procesit të rindërtimit”	BOE “Sh” Shpk & “T” Shpk	K.....N K.....G	123,320	123,320

7	“Rindërtimi në truallin ekzistues të 2 (dy) njësave të banimit (Pallate), pallati nr.1 dhe pallati nr.2 në Bashkinë Kurbin, në kuadër të procesit të rindërtimit”	BOE “K” SHPK “E” SHPK	K.....C J.....L	135,652	135,652
8	“Rindërtimi në truallin ekzistues të 2 (dy) njësave të banimit (Pallate), pallati nr.3 dhe pallati nr.4 në Bashkinë Kurbin, në kuadër të procesit të rindërtimit”	BOE “K” SHPK & “PE - V - K” SHPK & “U” SHPK	K.....C K.....M K.....Q	203,478	203,478
9	“Rindërtimi në truallin ekzistues të 2 (dy) njësave të banimit (Pallate), pallati nr.5 dhe pallati nr.6 në Bashkinë Kurbin, në kuadër të procesit të rindërtimit”	BOE “A & T-2010” Shpk & “E” Shpk	L.....T J.....L	135,652	135,652
Total				739,824	739,824

Burimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Sektori i Prokurimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, u auditua dokumentacioni për subjektet e ndërtimit, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Kurbin të cilat kanë kryer punime ndërtimi.

Në vijim të sa më sipër, po parashtrojmë kuadrin rregullator mbi të cilin është mbështetur ky akt-konstatim:

- Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar:

Neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:
b) vendosin taksat vendore e **tarifa për shërbimet**, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Neni 35 Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore

5. Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për:

a) shërbimet publike që ato ofrojnë;

Neni 54 Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

f) **vendos për taksat e tarifatat vendore**, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;

-Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”

Neni 3 Përkufizime

10. “Tarifë vendore” është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik **bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur** apo të drejta të dhënë nga njësisia e vetëqeverisjes vendore.

Neni 12 Rregulla të përbashkëta për taksat vendore

2. Baza e taksave dhe tarifave, si dhe niveli i tyre, **çdo përjashtim apo ulje, afati i pagesave, si dhe gjatësi e kamatëvonesat e aplikueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, botohen dhe bëhen të njohura publikisht.**

Neni 14 Tarifa vendore

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë të ardhura nga këto tarifa vendore:

b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve;

Neni 18 Të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve të tjera publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore propozojnë ose miratojnë, sipas legjislacionit në fuqi, tarifa për mbledhjen dhe heqjen e mbetjeve, si dhe për furnizimin me ujë dhe kanalizimet.

2. **Niveli i tarifave të shërbimeve publike**, si rregull, synon mbulimin e kostos dhe është në përpjesëtim të drejtë me konsumin nga individët, personat fizikë ose juridikë.

-Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit regjistrimet e tjera”, i ndryshuar

Neni 2 Përkufizime

6. “Regjistrim” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe çregjistrimin e subjektit nga regjistri.

Neni 43 Regjistrimet e tjera të detyrueshme

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

-Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Neni 40 Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

5. Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Udhëzimi nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KREU III Dispozita të përgjithshme administrative

23. Komunikimi me personat e tatueshëm

23.3.3 Komunikimi i vlerësimeve, njoftimeve, vendimeve dhe çdo akti tjetër zyrtar, nga ana e administratës tatimore, bëhet me postë elektronike ose në rrugë elektronike, nëpërmjet dërgimit të tyre në llogarinë e tatimpaguesit të hapur në sistemin elektronik të shërbimit tatimor, ose nëpërmjet dërgimit në adresën e postës elektronike (e-mail) të tatimpaguesit, kur një adresë e tillë i është njoftuar nga vetë tatimpaguesi administratës tatimore, sipas udhëzimit për pëlqimin e formës elektronike.

40. Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

Për çdo vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit të ndryshëm nga adresa kryesore, **personi fizik duhet të pajiset me një certifikatë me numër unik të identifikimit të tatimpaguesit të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes së re.**

40.4 Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka të njëjtin NIPT unik.

43. Ndryshimet në regjistrim 43.1

Sipas nenit 43 të ligjit, personat e tatueshëm që ushtrojnë veprimtari ekonomike e tregtare, janë të detyruar të deklarojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, çdo ndryshim të mëvonshëm që lidhet me emrin, adresën e selisë dhe të degëve, formën juridike, krijimin e mbylljen e degëve, ndryshimin e llojit të veprimtarisë, etj., siç përcaktohet në dispozitat ligjore për QKR. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend.

- VKB nr.91, datë 18.11.2022 për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023, tabela B.1.2, pika 4.5.6, paragrafi 4.4:

Përfundohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga Buxheti i Bashkisë apo Buxheti i Shtetit.

- Sa më sipër, konstatohet se në paketën fiskale për vitin 2023, janë përjashtuar nga pagesa e tarifës shërbimeve publike (gjelbërim, pastrim, ndriçim) subjektet të cilat kryejnë punime ndërtimi në Bashkinë Kurbin dhe NJA, financuar nga fondet publike, megjithëse ato kanë përfituar prej shërbimeve publike të ofruara (pastrim, gjelbërim, ndriçim) nga Bashkia Kurbin. Ky përjashtim që i është bërë këtyre subjekteve, bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën “b” të nënpikës 1.3 të pikës 1 në nenin 9, shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 35, shkronjën “f” të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pikën 10 të nenit 3 dhe pikën 2 të nenit 18 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

-Arkëtimi i tarifës së shërbimit dhe pastrimit.

-Në auditimin e kryer për ndjekjen e procedurave në krijimin e të ardhurave nga tarifata vendore për pastrimin dhe shërbimin ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi, u konstatua se nga DAV, Bashkia Kurbin, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit dhe shërbimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë. Nga përlllogaritjet e kryera rezultoi se për vitin 2023 në 9 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit në vlerën 739,824 lekë gjithsej, vlerë e cila është e pakontabilizuar dhe përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kurbin.

-Situata e mësipërme është krijuar si rrjedhojë e mosraportimit pranë DAV Bashkia Kurbin, të lejeve të ndërtimit të dhëna për subjektet e mësipërme, por edhe nga puna e pamjaftueshme DAV Bashkia Kurbin në verifikimin në terren të subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Kurbin.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
Kreu III. “Tarifa për Bizneset”, nënpika II.4 “Subjekte Ndërtimi” në Paketën Fiskale të Bashkisë Kurbin.

Konkluzion:

Nga auditimi konstatohet se deri në datën 31.12.2023 gjendja e debitorëve progresive për taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën 376,769 mijë lekë, e cila përbëhet nga:

- vlera prej **57,405 mijë lekë** për 539 subjekte debitorë të kategorisë biznes dhe institucione.
- vlera prej **17,400 mijë lekë** për 16 subjekte debitorë që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve.
- vlera prej **50,742 mijë lekë** për 1.485 subjekte debitor nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.
- vlera prej **131,152 mijë lekë** për 8,729 familje nga taksa e tokës Bujqësore.
- vlera prej **50,960 mijë lekë** për 63 subjekte nga gjobat e vendosura nga IMTV.
- vlera prej **65,686 mijë lekë** për taksat dhe tarifatat, taksa e ndërtesës, pastrimit, ndriçimit nga kategoria familjar.
- vlera prej **3,424 mijë lekë** nga kontratat e qirave për 3 subjekte, të cilat janë të kontabilizuara dhe janë likuiduar përgjatë vitit 2024.

Për vitin 2023 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara nga taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën **54,279 mijë lekë ose 14.4%** e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga: - detyrimi prej **4,678 mijë lekë** nga 52 subjekte debitor të kategorisë biznes dhe institucione, - detyrimi prej **7,871 mijë lekë** për 222 subjekte për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, -detyrimi prej 12,424 mijë lekë nga taksat dhe tarifatat, taksa e ndërtesës, pastrimit, ndriçimit nga kategoria familjar, -detyrimi prej **19,027 mijë lekë** nga taksa e tokës bujqësore, -detyrimi prej **10,626 mijë lekë** për 19 gjobat e vendosura nga IMTV, -detyrimi nga 3 kontratat e qirave në vlerën **1,553 mijë lekë**.

- **Përdorimi i të ardhurave.**

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2023 është realizuar në vlerën 100,600 mijë lekë ose 4.6% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për shpenzime operative, investime, paga dhe sigurime shoqërore.

Tabela nr.23

<i>000/lekë</i>		
Art.	Emërtimi	Të ardhurat e veta
600	Paga	22,502
601	Sigurime Shoqërore	5,157
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	42,617
604	Trans. Institucioneve	336
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0
231	Kapitale të Trupëzuara	29,986
	Total	100,600

Burimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, Z. A. B me detyrë, Drejtor i Planifikimit të të Ardhurave, znj. D. R me detyrë, Përgjegjëse e sektorit të të Ardhurave, z. N. C, me detyrë specialist terreni.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III.2.4. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit

financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

3.4. Verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale sa prej tyre janë me certifikatë pronësie.

➤ Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;

UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”,

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe zbatimi i rregullores “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”.

I. Pasqyrat financiare për vitin 2023 të Bashkisë Kurbin japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ndryshuar me ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE 8 datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”. Janë mbajtur ditaret e bankës, arkës, magazinës, veprimet e ndryshme. Disponohen aktrakordimet me thesarin Kurbin për shpenzimet dhe të ardhurat 2023. Llogaritë e aktiv-pasivit janë në pozicionin e tyre, janë të zbërthyera në mënyre analitike. Llogaritë në aktiv-pasiv të pasqyrave financiare kuadrojnë me anekset ose formatet përkatëse. Për vitin 2023 janë hartuar pasqyrat financiare për njësinë shpenzuese bashkia Kurbin dhe 3 njësitë administrative Mamurras, Fushë Kuqe dhe Milot. Në Bashkinë Kurbin nuk ka njësi varësie, të cilat të funksionojnë si njësi shpenzuese të pavarura, pra, nuk ka pasqyra financiare të konsoliduar. Bashkia Kurbin nuk ka aplikuar huamarrjen, kontrata koncesionesh dhe nuk ka shitje pronash apo dhënie me qira te tyre, në veprimtarinë e saj financiare. Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”). Në Bashkinë Kurbin, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, në programin kompjuterik Excel.

II. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 **paraqet me probleme**, pasi kanë peshë të madhe për vlerën **376,772,122 lekë**, që përfaqëson debitorët e taksave vendore, taksës infrastrukturës Aluiznit dhe debitorë të tjerë, **grafiku i se cilës është në rritje për 57,762,488 lekë**, krahasuar me vitin e mëparshëm 2022 (2023=376,772,122-319,009,634 lekë 2022) në vend që të ndodhte e kundërta.

Dinamika e debitorëve prej 376,772,122 lekë të kontabilizuara, paraqitet:

-Debitorë në fillim të vitit 2023 paraqiten gjithsej të 319,009,634 lekë.

-Shtesa të debitorëve gjatë vitit 2023 paraqiten 68,914,119 lekë.

-Pakësime të debitorëve gjatë vitit 2023 paraqiten 11,151,631 lekë.

Llogaria **423- 429 “Debitorë personeli gjoba dhe KLSH”** paraqet vlerën debitore prej 50,196,468 lekë, e zbërthyer ne: *gjoba të ndryshme të mbartura 48,610,343 lekë dhe me zbulime të KLSH të mbartura 1,586,125 lekë.*

Bashkia nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjore, për arkëtimin e vlerës debitorë 376,772,122 lekë (llog. 468) dhe për arkëtimin e vlerës debitore 50,196,468 lekë, (llog. **423 - 429**), në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik”,

pika 93, me ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe me ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi Procedurave Administrative në RSH” nenet 98 dhe 102.

III. Dokumentacioni i arkës paraqet disa mangësi për vitin 2023, pasi:

- Mandatarkëtimet (MA) për vitin 2023 nuk kanë nënshkrimin e finances.
- Të gjitha mandatpagesat (MP) për vitin 2023 nuk kanë nënshkrimin e financës dhe drejtuesit,
- Libri i arkës për mbylljet mujore të gjendjes fizike të saj nuk nënshkruhet nga përgjegjësja e financës, për efekt rakordimi financë-arkëtar.
- Arkëtimet janë kryer nëpërmjet arkës, në vend të derdhjes tyre në bankë, për taksat dhe tarifat vendore nga taksapaguesit si dhe për shërbimet e ndryshme të tjera, çka bie ndesh me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 61 dhe 64.

IV. Nga auditimi i veprimeve të magazinës dhe inventarët fizikë për vitin 2023, u konstatua:

a. Në 3 raste, fletudhëtimet e automjeteve paraqesin mangësi në plotësimin e tyre, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi:

- Vendosen distanca të ndryshme për linja të njëjta,
- Vendosen distanca km e përshtuara në linjat “Laç-Lezhë”, “Laç-Tiranë” jo sipas tabelës miratuar në DPSHTRR Tiranë.
- Autorizimet citojnë një arsye tip maket për gjitha rastet “Për nevoja pune të bashkisë”, pa përcaktuar saktë qëllimin e shërbimit.

b. Në fund të muajit në fletë udhëtimet është bërë rakordimi i karburantit të furnizuar me harxhimin e tij, sipas normativave të miratuara për 100/km, por km e përshtuara nuk janë verifikuar në automjete apo në aktkolaudimin (kontrolli teknik) të tyre, për efekt të saktësisë të km të pasqyruara në fletudhëtimet.

c. Nuk përcaktohet numëri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit në procesverbalet e komisionit para fillimit të inventarizimit, në kundërshtim me pikën 83 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

V. Asetet, kontabilizimi dhe pajisja me certifikatë pronësie.

Bashkia Kurbin disponon gjithsej të 3,309 prona të paluajtshme, përkatësisht: shkolla, troje, sheshe, pemëtore, zyra, rruge, pyje, kullota.

Regjistrimi në kontabilitet i aseteve është bërë pjesërisht nga bashkia Kurbin.

Bashkia Kurbin ka regjistruar në kontabilitet 164 prona të paluajtshme, përkatësisht troje, rrugë, ndërtesa, rrjete etj., me vlerë totale 3,191,209,826 lekë në vlerë historike.

*** 3,145 prona të paluajtshme nuk janë regjistruar në kontabilitet, në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ndryshuar me ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”.**

*** 3,309 prona të paluajtshme nuk janë pajisur me certifikatë pronësie pranë ASHK Lezhë, madje nuk ka pasur as aplikime për vitin 2023.**

***Pyje dhe kullota publike të transferuara** brenda juridiksionit të territorit bashkisë Kurbin, rezultojn sipërfaqja prej 11,350 ha, nga kjo 154 ha kullotë dhe 11,196 ha pyll, te cilat nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe nuk janë pajisur me certifikatë pronësie pranë ASHK Lezhë.

Zyra e Aseteve, Kadastrës dhe Juridike nuk kanë marrë masa për regjistrimin pranë ASHK të këtyre pasurive, për pajisjen e tyre me certifikatë pronësisë, në kundërshtim me ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” neni 18, me ligjin nr. 20/2020 “Për Kadastrën”, neni 43 “tarifat e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2, me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 37, 42, 60, 74, me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21, 22.

NË MËNYRË ANALITIKE.

4.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare:

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Kurbin” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, etj.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit: Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

*Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël).

*Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve të kryera dhe e mbartësve të tyre.

*Tërësinë e regjistrimeve kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor, nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet: *shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues, kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur, verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.*

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit: Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se: Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues. Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël. Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin. Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese. Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet. Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisë, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj. Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë

të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.

Për vitin 2023 janë hartuar pasqyrat financiare për njësinë shpenzuese bashkia Kurbin dhe 3 njësitë administrative Mamurras, Fushë Kuqe dhe Milot.

Në Bashkinë Kurbin nuk ka njësi varësie, të cilat të funksionojnë si njësi shpenzuese të pavarura, pra, nuk ka pasqyra financiare të konsoliduar.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale.

Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*”).

Në Bashkinë Kurbin, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, në programin kompjuterik Excel.

Pasqyrat financiare për vitin 2023, përbëhen nga:

- Formati nr. 1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*”;
- Formati nr. 2 “*Pasqyra e performancës financiare*” (*Klasifikimi sipas natyrës ekonomike*);
- Formati nr. 3 “*Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow)*”;
- Formati nr. 4 “*Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto*”;
- Formati nr. 5 “*Pyetësor dhe shënimet shpjeguese*”;
- Formati nr. 6 “*Investimet dhe burimet e financimit*”;
- Formati nr. 7/a “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)*”;
- Formati nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)*”;
- Formati nr. 8 “*Numri i punonjësve dhe fondi i pagave*”.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Kurbin për aktivitetin ekonomik-financiar për periudhën 01.01.2023, deri më datën 31.12.2023. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.

Është zbatuar afati ligjor për mbylljen dhe dorëzimin e bilancit 2023 të bashkisë Kurbin, pasi është brenda afatit ligjor 30 mars 2024.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Kurbin për vitin ushtrimor 2023, me shkresën përcjellëse nr. 1520 datë 28.03.2024, konfirmuar nga thesari me shkresën nr. 37 datë 28.03.2024.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Kurbin znj. M. C dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Financës R. K.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2023, nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (*dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj*) për shumat për çdo llogari në total, mujore dhe vjetore rezultoi se nuk ka diferenca.

Ditari i bankës është mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (*çeljet*) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Lidhur me operacionet buxhetore të bashkisë Kurbin është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kurbin si dhe nuk ka pasur në asnjë rast kontestime.

Është mbajtur rakordimi për shpenzimet vjetore, sipas situacionit për periudhën Janar-Dhjetor 2023 me nënshkrimin e të dyja palëve bashki-thesar.

Është mbajtur rakordimi për të ardhurat vjetore, sipas akt-rekordimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023 me nënshkrimin e të dyja palëve bashki-thesar.

Nuk ka kontrata koncesionesh dhe partneriteti si instrument financiar në veprimtarinë e saj.

Nuk ka të ardhura nga shitja e pronave.

Rakordimi i llogarive të aktiv-pasivit me pasqyrat financiare (anekset) ose formatet përkatëse.

- Totali aktivitet të bilancit 2023 rakordon me totalin e pasivit të bilancit për shumën 5,087,895,452 lekë, **Formati nr. 1** “pasqyra e pozicionit financiar”.

- **Rezultati i veprimtarisë** ushtrimore 2023 **llogaria 85** pasqyrohet në bilanc formati nr. 1 për vlerën 1,170,565,525 lekë (të ardhurat 3,344,329,878 – 2,173,764,353 shpenzimet) dhe rakordon me të njëjtën vlerë të formatit nr. 2 “pasqyra e performancës financiare”) ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve llogaria 85.

- Teprica e “likuiditeteve në fund të vitit ushtrimore 2023” për vlerën 1,326,072,378 lekë pasqyruar në formatin 3 “pasqyrën e flukseve monetare”, rakordon me **llogarinë 520** “Disponibilitete në thesar” e pasqyruar në formatin nr. 1 “pasqyrën e pozicionit financiar”.

- Teprica debitorë e **llogarisë 532** “letra me vlerë” formati nr. 1 “pasqyrën e pozicionit financiar” për vlerën 27,000 lekë rakordon me gjendjen fizike të letrave me vlerë për 27,000 lekë (pulla gjendjes civile).

- **llogaria 531** “mjete monetare në arkë” rezulton zero e mbyllur në fund të vitit 2023, sipas bilancit.

- **Fondi i konsoliduar** 4,461,744,000 lekë i evidentuar tek formati 1 “pasqyra e pozicionit financiar” pika D, rakordon me vlerën gjithsej të fondeve prej 4,461,744,000 lekë, pasqyruar tek formati 4 “pasqyra e ndryshimeve të fondeve”.

- Gjendja e **llogarisë 101** “Teprica (Fondi i akumuluar)/ Deficiti i akumuluar” (Kapitali i nënshkruar) në datën 31.12.2023, paraqitet për vlerën 2,730,005,638 lekë nga 2,930,208,737 lekë viti 2022.

- **Llogaritë 105** “Teprica e Granteve kapitale të brendshme” rezulton e regjistruar në vlerën 536,020,305 lekë.

- **Llogaria 106** “Teprica e Granteve kapitale të huaja”, si për periudhën ushtrimore dhe paraardhëse, pasqyrohet me vlerën 0 (zero).

- Në pasqyrën financiare **llogaria 26** “pjesëmarrje në kapitalin e vetë” është për shumën 12,843,232 lekë, e cila përbëhet nga: fond pjesë në shoqatën e UK Durrës 2,4 % e aksioneve në vlerën 10,728,232 lekë, fond pjesë në shoqatën e UK Lezhë 12,4 % e aksioneve në vlerën 1,240,000 lekë, me Klub-futbollin Laç 25 % aksioneve me vlerë 875,000 lekë.

- **Pasqyra e lëvizjes fondit pagave** pasqyron në fillim të vitit 455 punonjës dhe në fund të vitit 2023 pasqyron 487 punonjës gjithsej, ku rreth 50 % e tyre janë arsimi, gjendja civile, zjarrfikëset me fonde të deleguara.

Kjo pasqyrë aneks formati nr. 8 rakordon me të dhënat e pasqyrës shpenzimeve për paga dhe kontribute sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të formatit nr. 2, përkatësisht:

* **Fondi i pagave** i pasqyruar në formatin 2, pika B “shpenzimet”, **llogaria 600** paraqitet për vlerën 294,928,071 lekë, e cila rakordon me formatin 8 “numri i punonjësve dhe fondi i pagave”.

* **Fondi për kontribute sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore** prej 50,279,872 lekë, **llogaria 601** formati 2, pika B “shpenzimet”, rakordon me formatin 8 “numri i punonjësve dhe fondi i pagave”.

- **Aktivitet afatgjata jo materiale** “studime e kërkime” (**llog. 202**) për 3,100,656 lekë në formatin 1 “pasqyra e pozicionit financiar” kuadron me formatin 7/b “Gjendja e ndryshimeve të aktiveve afatgjata”.

- **Aktivitet afatgjata materiale** llogaria **210-218** për 2,606,172,197 lekë në formatin 1 “pasqyra e pozicionit financiar” kuadron me formatin 7/b “Gjendja e ndryshimeve të aktiveve afatgjata”. Aktivitet afatgjata gjithsej të 4 automjeteve (3 makina dhe 1 autobus) janë dhëne për

përdorim brenda sistemit SHA KUZ. Disponohet inventarizimi i llogarisë 218 inventar ekonomik dhe kuadron me formatin 7/a të bilancit 2023, në mënyrë analitike pasqyrat edhe për llogaritë e tjera në kapitullin anekse bashkëngjitur project raportit të auditimit. Aktivitet afatgjatë janë nënshtruar aplikimit të normave të amortizimit për çdo aktiv.

- **Llogaria 202** “*Studime dhe kërkime*” pasqyrohet në bilanc për vlerën 3,100,656 lekë dhe është e zërthyer në mënyrë analitike në 20 studime dhe projekte të bëra hyrje, sipas pasqyrës analitike.

- **Gjendja e inventarit qarkullues (llogaria 327** inventar i imët) pasqyrohet për vlerën 57,693,085 lekë në formatin nr. 1 dhe është bërë inventarizimit fizik në fund të vitit 2023.

Për vitin 2023 nuk ka nxjerrje jashtë përdorimit të materialeve dhe mjeteve kryesore, sipas të dhënave të bilancit formati 7/a, kolona paketime, zëri nxjerrje jashtë përdorimi.

- **Llogaria 211** “*Pyje, kullota, plantacione*” më datën 01.01.2023 ka qenë në vlerën 9,414,833 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, pra më 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie paraqitet po në vlerën 9,414,833 lekë.

- **Llogaria 212** “*ndërtesa e konstruksione*” gjendja kontabël në aktiv është 1,408,612,455 lekë dhe kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek aneksi i PF formati 7/b, teprica neto, sipas pasqyrës analitike bashkëngjitur. Kjo llogari gjatë vitit 2023 nuk ka pakësime, përveç amortizimit, por ka 2 shtesa me vlerën 233,710,031 lekë, përkatësisht:

* Blerje 233,207,354 lekë që bën fjalë për investime të marra në dorëzim në 2023 dhe që janë: “Rikonstruksioni i shkollës nr. 3 Laç” me vlerë 95,948,112 lekë, “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Mark Trokthi Laç” me vlerë 98,458,552 lekë dhe “Rikonstruksion i terreneve sportive Mark Trokthi Laç” me vlerë 38,800,690 lekë.

* Nga arsimi vlera 502,677 lekë.

- **Llogaria 213** “*rrugë, rrjete, vepra ujore*” gjendja kontabël në aktiv është 1,008,937,383 lekë dhe kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek aneksi i PF formati 7/b, teprica neto. Kjo llogari është zërthyer analitikisht, sipas pasqyrës ngjitur.

- **Llogaria 214** “*Instalime teknike, makineri dhe pajisje*” gjendja kontabël në aktiv është 11,585,128 lekë, kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek aneksi i PF formati 7/b. Kjo llogari është zërthyer analitikisht sipas makinerive dhe pajisjeve teknike bashkëngjitur lista. Kjo llogari gjatë vitit 2023 nuk ka pakësime, por ka shtesa blerje për vlerën 4,254,960 lekë, përkatësisht: blerje kontenier 1,977,600 lekë dhe blerje materiale elektrike për ndriçim rrugor për vlerën 2,277,360 lekë. Kjo llogari disponon inventarin fizik të saj sipas zërave analitik për vlerën 64,038,802 lekë bashkë me amortizimin, e cila kuadron me formatin 7/a të bilancit 2023.

- **Llogaria 215** “*mjete transporti*” gjendja kontabël në aktiv është 36,105,893 lekë, kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek aneksi i PF formati 7/b. Kjo llogari nuk ka pakësime dhe as shtesa gjatë vitit 2023. Mjetet e transportit janë zërthyer në zëra analitik prej 15 mjetesh të ndryshme, për të cilat disponohet inventari kontabël duke përcaktuar dhe drejtuesit ose përdoruesit e tyre. Gjithashtu kjo llogari disponon inventarin fizik të mjeteve të transportit për vlerën 66,233,225 lekë bashkë me amortizimin, e cila kuadron me formatin 7/a bilancit 2023.

- **Llogaria 24** “*Aktive afatgjatë të dëmtuara*”, perfaqeson 1 automjet Zjarrfikëse të dëmtuar jo në gjendje pune, në kushte të tilla ky aktiv është kontabilizuar, në përputhje me Udhëzimin Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

- **Llogaria 210** “*toka, troje, terrene*” gjendja kontabël në aktiv është 8,652,463 lekë, kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek aneksi i PF formati 7/b. Kjo llogari 210 është e zërthyer në mënyrë analitike në 4 objekte tokë, nga këto 2 tokë dhe 2 truall për ish- njësinë Mamurras dhe varrezat Gurëz Fushë Kuqe. Gjatë vitit 2023 nuk ka raste shtesë ose pakësime.

Llogaritja e amortizimit të aktiveve për vitin 2023 pasqyrohet për vlerën 163,368,160 lekë (1,412,102,807 lekë amortizimi i akumuluar ndër vite), pasqyruar tek formati 7/b, sipas zërave të aktiveve, ndërsa sipas zërave analitik pasqyrat bashkëngjitur. Amortizimi i mjeteve kryesore është bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar, pika 3.7 “*Amortizimi*”,

si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

- **Llogaria 230-231** investime pasqyrohet në formatin nr. 1 “pasqyra e pozicionit financiar” për vlerën 561,172,837 lekë (investimeve në proces), e cila përbëhet nga këto investime analitike:

- * 498,115,862 lekë ndërtim rrjeti ujësjellësit Laç,
- * 4,297,600 lekë supervizim ndërtim i rrjeti ujësjellësit Laç,
- * 4,393,530 lekë ndërtim KUZ Milot,
- * 108,000 lekë supervizim ndërtim rrjeti ujësjellësit Milot,
- * 13,603,488 lekë sistemim asfaltim rruga Fushë Gjorm,
- * 115,680 lekë mbikëqyrje sistemim asfaltim rruga Fushë Gjorm,
- * 14,187,652 lekë asfaltim rehabilitim rruga Ferr Trashë Fushë Mamurras,
- * 116,520 lekë supervizim asfaltim rehabilitim rruga Ferr Trashë Fushë Mamurras,
- * 9,972,600 lekë rehabilitim rruga Mal Milot,
- * 99,000 lekë supervizim rehabilitim rruga Mal Milot,
- * 15,844,944 lekë rikonstruksion rruga lagjja nr. 2 Laç,
- * 317,961 lekë kolaudim punimesh Fasada II,

- **Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën debitorë **376,772,122 lekë**, që përfaqëson **debitorët e taksave vendore dhe taksën infrastrukturës Aluiznit si dhe gjoba e detyrimeve kontraktore të tjera**. Dinamika e lëvizjes së debitorëve gjatë vitit 2023 paraqitet:

-Debitorë në fillim të vitit 2023 paraqiten gjithsej në vlerën 319,009,634 lekë,

-Shtesa e debitorëve gjatë vitit 2023 paraqiten në vlerën 68,914,119 lekë,

-Pakësime të debitorëve gjatë vitit 2023 paraqiten në vlerën 11,151,631 lekë,

Ne mënyrë të grupuar debitorët paraqiten sipas pasqyrës, sa vijon:

Tabela nr.24

NR.	EMERTIMI	Llog: 468	Debitor me 31.12.2023 në leke
1.	Takse toke bujqësore		131,152,747
2.	Abonent familjar		65,686,236
3.	ALUIZNI Takse infrastrukturës 0,5 %		50,742,920
4.	Takse biznesi BM +BV		57,405,482
5.	Gjoba IMT		50,960,424
6.	Tarife licence hidrokarbureve		17,400,000
7.	Detyrim kontraktor + taksa HEC		3,424,313
	SHUMA		376,772,122

- **Llogaria 423- 429 “Debitorë personeli gjoba dhe KLSH”** për vlerën debitorë prej 50,196,468 lekë.

- Sipas pasqyrës rezulton se peshën më të madhe të **debitorëve e zënë debitorët e tokës bujqësore** për vlerën 131,152,747 lekë, të cilat me hollësisht janë trajtuar të pika e taksave e tarifave vendore.

- Dinamika e debitorëve për vitin 2023 është në rritje për vlerën 57,762,488 lekë, krahasuar me vitin 2022 (2023=376,772,122- 319,009,634 lekë 2022) në vend që të ndodhte e kundërta.

- Bashkia Kurbin për debitorët është mjaftuar vetëm me disa njoftime dhe bllokime banke pa u shoqëruar me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave debitorë, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115 të Kodit Civil në RSH dhe nenit 203 të Kodit Punës në RSH.

- Bashkia nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjore, për arkëtimin e vlerës debitorë 376,772,122 lekë dhe 50,196,468 lekë, detyrime të pranuar dhe kontabilizuara nga bashkia, në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”, pika 93, me ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe me ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi Procedurave Administrative në RSH” nenet 98 dhe 102, çka bën përgjegjës drejtoreshën e financës R. K, specialistët financës R. P dhe F. Gj.

* **Llogaria 423- 429 “Debitorë personeli gjoba dhe KLSH”** paraqitet në vlerën debitorë **50,196,468 lekë**, që përfaqëson debitorët dhe gjoba të ndryshme të mbartura, e cila zbërthehet:
-Gjoba të ndryshme dhe të mbartura paraqiten 48,610,343 lekë.
-Zbulime të KLSH paraqiten 1,586,125 lekë.

Në mënyre analitike debitorët paraqiten sipas kapitullit anekse *bashkëngjitur raportit përfundimtar të auditimit*.

Llogaritë e Aktivit dhe Pasivit të bilancit 2023 bashkia Kurbin, paraqiten në kapitullin *Anekse, tabela nr. 31*:

Mënyra e mbajtjes kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues dhe sigurimi informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore. Kështu u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për vlefshmërinë për t'u pranuar në kontabilitet (*vlerësimi kontabël*);

Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve të kryera dhe e mbartësve të tyre;

Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit vlefshmërisë regjistrimit fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (*barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive*) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë.

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se: Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

Kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.

Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

Azhurnimet e veprimeve ekonomike në partitarët analitik janë kryer në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, pagave, të ndryshme etj. Është mbajtur libri i madh apo centralizator duke kaluar veprimet e llogarive nga ditarët perkatës në center, duke nxjerre saldot debitorë dhe kreditorë të kuadruara, mbi bazën e të cilave është hartuar bilanci kontabel 2023.

Kalimet e llogarive nga ditaret në center dhe në bilanc janë pa gabime dhe të kuadruara debia me kredinë. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet. Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues në përgjithësi është bërë i plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Kështu: Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente

shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj. Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur angazhimeve, duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare e rezultatet nënjësisë ekonomike.

4.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ndryshuar me ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE 8 datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2023, konkretisht:

-Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2023 është marrë në shqyrtim dokumentacioni si pasqyrat financiare të vitit 2023, ditari i bankës, ditari i arkës, ditari i magazinës, aktrakordimet me Degën e Thesarit Kurbin, inventarët etj.

Kriteret e vlerësimit: Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar, UMFE 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, UMF 30 datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Bashkia Kurbin ka përgatitur dhe raportuar pasqyrat financiare të vitit 2023, mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë qeverisjes së Përgjithshme”. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kurbin, si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

-Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2023 janë: pasqyra e pozicionit financiar (F1), pasqyra e performancës financiare (F2), pasqyra e flukseve monetare (F3), pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4), pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5), pasqyrat statistikore, investimet dhe burimi i financimit (F6), gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a), gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b), numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8).

Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ku është dhënë informacion mbi:

Emrin e njësisë ekonomike raportuese, *Bashkia Kurbin NIPTI K.....C*, nëse pasqyrat financiare mbulojnë një njësi ekonomike raportuese individuale apo grup njësisish, periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2023-31.12.2023, monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë, data e hartimit të pasqyrave financiare me 28.03.2024.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Janë mbartur saktë tepricat e llogarive të vitit 2022 në celjen vitit pasardhës për bilancin e vitit 2023 dhe rakordojnë.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e Pasqyrave Financiare.

Bashkia Kurbin nuk ka aplikuar huamarrjen, kontrata koncesionesh dhe nuk ka shitje pronash apo dhënie me qira të tyre, në veprimtarinë e saj financiare.

Baza e matjes së përdorur mbi të cilën janë përgatitur të gjitha pasqyrat financiare janë sipas kostos historike.

Nuk ka ndryshim të politikave në plotësimin e pasqyrave financiare nga një periudhë kontabël në tjetrën. Pasqyrat financiare të vitit 2023 janë paraqitur të plota.

Analiza e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim, sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” të bilancit të vitit 2023, paraqitet në kapitullin Anekse, tabela nr.32:

Të ardhurat dhe shpenzimet 2023.

Të ardhurat dhe shpenzimet janë pasqyruar saktë tek pasqyra shpjeguese për raportimin e Pasqyrave Financiare vjetore 2023, **formati 2**, përkatësisht:

a. Të ardhurat total pasqyrohen 3,344,329,878 lekë, e cila kuadron me të ardhurat sipas grupeve:

* Të ardhura nga taksat dhe tatimet për 31,111,265 lekë,

* Të ardhura jo tatimore për 13,974,950 lekë,

* Grante korente për 3,299,243,663 lekë,

b. Shpenzimet total pasqyrohen për 2,173,764,353 lekë, e cila kuadron me shpenzimet sipas grupeve:

* Paga dhe përfitime punonjësve për 294,928,071 lekë,

* Kontribute të sigurimeve për 50,279,872 lekë,

* Blerje mallra e shërbime për 290,824,621 lekë,

* Transferime korente për 1,547,883,033 lekë,

* Ndryshim i gjendjes inventarit për -10,151,244 lekë,

c. Teprica dhe deficit i periudhës 2023 rezulton për vlerën 1,170,565,525 lekë (të ardhurat 3,344,329,878 –2,173,764,353 shpenzimet) dhe kuadron me llogarinë 85 të formatit nr. 1 bilancit.

TË ARDHURAT

- Të ardhura nga taksat dhe tatimet llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”, në datën 31.12.2023 paraqitet në PF **Formati 2** në vlerën 31,111,265 lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 pasqyrohet për vlerën 29,715,584 lekë, ose me rritje të të ardhurave në vlerën 1,395,681 lekë.

- Të ardhura jo tatimore, llogaria 71 në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 13,974,950 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 18,065,804 lekë ose me një ulje në vlerën 4,090,854 lekë.

Të ardhurat tatimore dhe jo tatimore janë paraqitur në mënyre analitike në pasqyrën financiare dhe pasqyrën e taksave e tarifave vendore.

- “Grante korente” nga grandit korent i brendshëm (granti korent i huaj nuk ka), llogaria 72 në datën 31.12.2023 pasqyrohet në vlerën 3,299,243,663 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 3,534,171,061 lekë ose me ulje në vlerën 234,927,398 lekë.

SHPENZIMET

Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria **600** “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”, në datën 31.12.2022 pasqyrohet në vlerën 244,587,558 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie është **294,928,071 lekë** ose **me rritje në vlerën 50,340,513 lekë**. Bashkia Kurbin ka në organike 552 punonjës, nga këto: bashkia ka 281 punonjës (bashkia=224+57 të 3 njësitë administrative) dhe 241 institucionet në varësi, sipas urdhrimit të titullares nr. 2 datë 03.01.2023 dhe VKB nr. 104 datë 21.12.2022).

-Llogaria **601** “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie pasqyrohet 50,279,872 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Kurbin me të njëjtën vlerë.

- Shpenzime, **602** për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit. Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datën

31.12.2022 paraqitet në vlerën 234,462,438 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie pasqyrohet për **290,824,621 lekë** ose me **rritje në vlerën 56,362,183 lekë**. U konstatua se shpenzimet operative ndaj shpenzimeve për paga kanë një raport të zhdrejtë midis tyre, në vend që të ndodhte e kundërta, pasi ato janë të barabarta ose zënë 98,6 % ndaj shpenzimeve të pagave. Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime 602 pasqyrohet më analitikisht tek buxheti, pasqyra e shpenzimeve operative.

Shpenzimet e vitit 2023 janë të rakorduara me Degën e Thesarit Kurbin me të njëjtën vlerë, sipas situacionit vjetor të shpenzimeve.

- **Ligjshmëria** dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës:

Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*”, si dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*” pikat 63,64.

Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet.

- **Subvencionet** përfshijnë ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Kurbin nuk ka pasur subvencione.

- **Transferimet korente** përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Transferime korente, në datën 31.12.2022 paraqiten në vlerën 2,167,935,668 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,547,883,033 lekë ose me ulje në vlerën 620,052,635 lekë.

- **Shpenzimet financiare**, paraqitet në vlerën zero.

4.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës si dhe magazinës. ARKA 2023.

Veprimet e arkës për vitin 2023 në përgjithësi kanë përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “*Për kontabilitetin*” ndryshuar me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*”.

Me arkën janë kryer transaksione financiare për arkëtimin e tarifave dhe taksave vendore dhe shërbimeve tjera, për të cilat janë prerë mandate arkëtimet të plotësuara me të gjitha ekstremitet.

Të ardhurat e krijuara në arkë, përbëhen nga: arkëtimi i taksave tokës bujqësore, taksa familjare, taksa biznesi i vogël, taksë ndërtese, taksë shërbimi, taksë trualli, tarifë pastrimi, gjelbërimi e ndriçimi, të ardhura nga kopshtet, gjoba policia Bashkiake, taksë leje transporti, të ardhura nga shërbimi i MZSH dhe gjendjes civile si dhe sportit, e të tjera.

Mandatpagesat dhe mandatarkëtimet janë prerë sipas numrit kronologjik dhe në përgjithësi janë plotësuar me gjithë të dhënat dhe pa mangësi.

U verifikuan me zgjedhje mandatarkëtimet e bankës për derdhjet mujore të hollave nga arka e bashkisë sipas MP përmbledhëse dhe nuk rezultuan diferenca, përkatësisht:

-MP nr. 9 datë 29.09.2023 për vlerën 307,089 lekë derdhur në Tirana Bank, rakordon me vlerën e mandatarkëtimeve të Tirana Bank.

-MP nr. 10 datë 31.10.2023 për vlerën 378,288 lekë derdhur në Tirana Bank, rakordon me vlerën e mandatarkëtimeve të Tirana Bank.

-MP nr. 1 dhe nr. 12 datë 29.12.2023 për vlerën 227,147 lekë derdhur në Tirana bank, rakordon me vlerën e mandatarkëtimeve të Tirana Bank.

U verifikua përmbledhësja e mandatarkëtimeve të muajit prill 2023 dhe rezultoi se përputhet me totalin për vlerën 173,460 lekë, e pasqyruar tek libri i arkës si dhe e derdhur në bankë sipas MP nr. 4 datë 28.04.2023 për këtë vlerë.

Mandatpagesat janë kontabilizuar periodikisht në ditarin e arkës dhe shoqërohen me dokumentet bazë dhe justifikuese, sipas natyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Janë bërë azhurnimet përkatëse në mënyrë analitike.

Mandatpagesat janë prerë dhe nënshkruar nga arkëtarja E. Sh.

Libri i arkës është plotësuar për çdo muaj dhe është nënshkruar nga armëtaria, për hyrjet dhe daljet e të hollave.

Hyrjet në arkë shoqërohen me dokumente (*fatura për arkëtim ose vërtetim e tjerë*) përkatës të taksës apo shërbimit kryer, përlogaritur nga drejtoritë përkatëse me autorizim të titullares së bashkisë.

Disponohet regjistrimi mujor dhe vjetor i të ardhura të derdhura në bankë për vitin 2023 për vlerën totale 2,551,324 lekë, vlerë e njëjtë me totalin e arkëtimeve 2023.

Janë kryer periodikisht rakordimet midis arkëtares dhe financës bashkisë, për hyrjet dhe daljet mujore të hollave, krijuar nga taksapaguesit për vitin 2023.

Janë kryer rakordimet midis arkëtares dhe financës bashkisë, për gjendjen kontabël me gjendjen fizike të arkës me 31.12.2023, **Ilogaria 531 “Mjete monetare në arkë”**, e cila paraqitet me vlerën 0 (zero), sipas aktivitetit të bilancit 2023, formati nr. 1.

Janë kryer rakordimet midis arkëtares dhe financës bashkisë për gjendjen fizike të pullave gjendjes civile me 31.12.2023, **Ilogaria 532 “vlera tjera, (letra me vlerë)”**, e cila paraqitet me vlerën 27,000 lekë, e cila rakordon me aktivitetin e bilancit 2023, formati nr. 1.

Mbajtja e kontabilitetit të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera nëpërmjet arkës është realizuar në ditarin e arkës. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas mandat-arkëtimeve dhe mandatpagesave.

Kontabilizimi i të ardhurave është bërë i saktë në llogaritë e klasës 7 sipas llojeve të ardhurave dhe kuadron me akt-rakordimin e me thesarin për të ardhurat.

Është respektuar limiti i arkës për vitin 2023, pasi arka paraqitet me të holla brenda limitit të saj dhe derdhen në bankë në fund të çdo muaji periodikisht, sipas kërkesave të pikës 3 në VKM 290 datë 14.6.1993 “Për limitin arkës”.

Nga auditimi i dokumentacionit të arkës të bashkisë Kurbin për vitin 2023 u **konstatuan këto mangësi**, si vijon:

* ***Të gjitha mandatarkëtimet (MA) për vitin 2023 nuk kanë nënshkrimin e financës***, por janë mjaftuar vetëm me firmën e arkëtares.

* ***Të gjitha mandatpagesat (MP) për vitin 2023 nuk kanë nënshkrimin e financës dhe drejtuesit***, por janë mjaftuar vetëm me firmën e arkëtares.

* ***Libri i arkës nuk ka nënshkrimet e përgjegjësës financës, për mbylljet mujore të gjendjes fizike të arkës***, për efekt rakordimi financë-arkëtar.

* ***Arkëtimet janë kryer nëpërmjet arkës, në vend të derdhjes tyre në bankë***, për taksat dhe tarifatat vendore nga taksapaguesit si dhe për shërbimet e ndryshme të tjera, çka bie ndesh me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 61 dhe 64. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”, pika 36.

Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. R. K, me detyrë Drejtoresh e Financës, znj. E. Sh, me detyrë Arkëtare.

BANKA 2023.

Auditimi mbi veprimet e bankës për vitin 2023 është kryer bazuar në programin e auditimit, ku rezultoi se: Auditimi u krye me zgjedhje, me metodën hap pas hapi, me teknikën e auditimit të shqyrtimit të dokumentacionit justifikues të veprimtarisë së këtij sistemi për të vlerësuar që kontrollat e brendshme nëse kanë qenë efektive.

Për periudhën e audituar veprimet e kryera nëpërmjet bankës janë të dokumentuara me urdhërpagesat përkatëse, të nënshkruara nga nëpunësi zbatues dhe janë konfirmuar nga dega e thesarit të rrethit.

Urdhërshpenzimet mbajnë numra rendor progresiv dhe veprimet ekonomike janë hedhur rregullisht në ditarin e bankës dhe ditarin e shpenzimeve sipas nënzërave përkatës.

Vlera e urdhërshpenzimeve të likujduara përputhet me vlerën e detyrimit për shërbimet dhe mallrat e kontraktuara.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si: urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Llogaritë janë në pozicionin e duhur në përputhje me kërkesat ligjore, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes Përgjithshme”, i ndryshuar dhe me Udhëzimet Ministrisë Financave.

Likuidimet e kryera nëpërmjet bankës për vitin 2023 i përkasin:

- Shlyerjes së pagave, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të punonjësve bashkisë, arsimit bazë, parashkollor, mesëm, pagesave të ndihmës ekonomike dhe paaftësisë, shpërblim mujore të anëtarëve KB dhe kryepleqve lagjeve dhe fshatrave.

- Shpërblime me 5,000 - 10,000 lekë për punonjësit e bashkisë dhe njësite administrative në fund të vitit 2023, bazuar në VKM nr. 766 datë 21.12.2023 “Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për vitin 2023”.

- Shlyerjes shpenzimeve të pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, mirëmbajtjes varrezave, të qytetit Laç dhe Mamurras si dhe Milot.

- Shlyerjes shpenzimeve të mirëmbajtjes së rrugëve rurale.

- Shlyerjes së shpenzimeve për dekor qytetit me rastin e festive të fund vitit.

- Likuidime karburantit dhe shërbimeve për automjetet e bashkisë (pjesë këmbimi, goma, vajë filtra).

- Likuidime situacionesh ose garanci objektesh investimesh, supervizor dhe kolaudator.

- Likuidime për blerje të vogla (mallra ushqimor për çerdhet, materiale sanitare, pastrimi, kancelari, shtypshkrime, materiale ndërtimi dhe elektrike, materiale dizefektimi, rroba sportive, pelet për ngrohje shkolla, etj.).

- Likuidime për banorët për shtëpitë e dëmtuara nga pasojat e tërmetit nga granti llog. 604.

- Likuidime për forcim pallatesh të dëmtuara nga pasojat e tërmetit nga granti llog. 604.

- Likuidime për qira banese për banorët e pastrehë si pasojë e dëmtimit të shtëpive të tyre nga pasojat e tërmetit.

- Likuidime gjyqësore të prapambetura.

- Likuidime për sportin klub futbollin Laç.

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve me **bankën për vitin 2023**, rezultoi:

1. Me veprimet e bankës 2023, lidhur me likuidimet nga granti llog. 604, për ndërtimin dhe rikonstrukcionin si dhe për forcimin e shtëpive, apartamenteve dhe pallateve të dëmtuara nga pasojat e tërmetit, u konstatua se disponohen faturat dhe situacionet me nënshkrimin e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit si dhe titullarit bashkisë Kurbin, por **mungojnë akt marrjet në dorëzim midis 2 palëve: firmës sipërmarrëse dhe palës të interesuar të banorëve ose përfaqësuesve të tyre**, lidhur me vërejtjet që ata mund të kenë, ose që janë dakord me punimet. Theksojmë se për rindërtimin janë ndaluar 5 % për garanci defektsh dhe nga bashkia ka komision për marrjen në dorëzim, por mungon pala e interesit banorët, administratorët apo kryepleqtë e lagjeve e fshatrave.

2. Shpenzime pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes varrezave.

Për vitin 2023 shpenzimet e pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes varrezave të qytetit Laç dhe 3 njësite administrative kryhen me sipërmarrje private me procedurë prokurimi publik, përkatësisht subjekti “V... R shpk dhe “B” shpk si dhe “L -2014” shpk.

Transporti i mbetjeve urbane kryhet nga Bashkia Kurbin dhe 3 njësite administrative për në landfillin Bushat ku depozitohen mbetjet urbane, sipas peshimeve të subjektit “Ndërkomunale “Bushati” sha.

Mbikëqyrja e pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes varrezave kryhet nga supervizori i bashkisë.

Nga auditimi i dokumentacionit të pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes varrezave të bashkisë Kurbin për vitin 2023, u konstatuan **mangësi dokumentare**, konkretisht:

a. Mungojnë informacionet mujore dhe procesverbalet ditore (bashkëngjitur situacioneve mujore), për pasqyrimin e vërejtjeve dhe zbritjeve për punë të pakryera të konstatuara, në kundërshtim me pikën 8 të rregullores brendshme të bashkisë Kurbin, ku thuhet:

Mban procesverbale ditore për punën e pakryer për çdo zë pune dhe bën vlerësimin e tyre në lekë sipas detyrimeve kontraktuese. Procesverbali duhet të firmoset nga administratori i kompanisë së pastrimit dhe gjelbërimit apo përfaqësuesi i autorizuar ligjërish prej tij.

Por është mjaftuar vetëm me faturat dhe situacionet mujore të punimeve, të cilat nuk pasqyrojnë asnjë zbritje të punimeve të pakryera. Theksojmë se disponohen disa procesverbale ditore, por nuk kanë zbritje dhe efekte, për rrjedhojë kanë trajtën e relacionit dhe jo procesverbalit.

b. Në situacionet mujore nuk pasqyrohet asnjë zbritje të punimeve të pakryera të pastrim, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes varrezave.

c. Në situacionet mujore nuk pasqyrohen ditët me shi, madje për gjithë vitin 2023.

d. Në situacionet mujore nuk ka asnjë zbritje për fshirjet e rrugëve, shesheve, trotuareve, të cilat kanë qënë të zëna nga rikonstruksionet për vitin 2023, objekt investimesh, konkretisht: për objektet “Ndërtim rrjeti ujësjellësit Laç”, “Ndërtim KUZ Milot”, “Ndërtim rrjeti ujësjellësit Milot”, “Sistemim asfaltim rruga Fushë Gjorm”, “Rikonstruksion rruga lagjja nr. 2 Laç”, etj.

Kështu, vetëm për investimin e fundit “**Rikonstruksion rruga lagjja nr. 2 Laç**” u konstatua sipërfaqja 3,720 m² dhe 710 m² e zënë nga punimet me asfaltbeton në rrugë e trotuare, për periudhën 3-mujore (Janar-Prill 2023), sipas kontratës 30.01.2023 dhe situacionit nr. 1 datë 11.04.2023 si dhe urdhër shpenzimit nr. 654 datë 05.05.2023, rezulton vlera **13,820 lekë punë e pakryer** për firmën e pastrimit “**B**” shpk, përkatësisht sipas zërave të punës: zëri “Fshirje rruge dhe trotuarë” për sipërfaqen $3720 + 710 \text{ m}^2 \times 0.91 \times 3 \text{ muaj} = 12,093 \text{ lekë}$ dhe zëri “Mirëmbajtje rrugëve, shesheve” për sipërfaqen $3,720 + 710 \text{ m}^2 \times 0.13 \times 3 \text{ muaj} = 1,727 \text{ lekë}$.

e. Në situacionin mujor zëri “lagje rrugësh” pasqyrohet për 100 ditë, në vend të 30 ditëve për vlerën 226,941 lekë ($292903 \text{ m}^2 \times 0,7748 \text{ lekë/m}^2 = 226,941 \text{ lekë}$).

-Zëri “mirëmbajtje varrezash dhe hapësirave publike” nuk zbërthehet në zëra analitike sipas zërave të punës, por pasqyrohet në vlerën 484,999 lekë, vlerë të njëjtë për çdo muaj.

Për 2 zërat e fundit sipas urdhër shpenzimit nr. 1657 datë 03.10.2023 dhe nr. 613 dhe nr. 615 datë 02.05.2023 për subjektin “V... R shpk dhe “B” shpk.

Sa më sipër, për mangësitë e konstatuara, pa mohuar punën e bërë mban përgjegjësi supervizori i bashkisë z. R. T dhe znj. R. K me detyrë Drejtore e Financës.

3. Në 1 rast, u konstatua **vonesa në likuidimin e faturës** nr. 183 datë 02.04.2019 të subjektit “S” shpk likuiduar për diferencën 3,709,021 lekë, sipas urdhër shpenzimit 1792 datë 12.10.2023, pra **3 vjet me vonesë**, në vend që të likuidoheshin në afatin e duhur prej 30 ditë, në kundërshtim me: UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, me Udhëzimin plotësues “Për buxhetin e vitit”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, ku thuhet:

Neni 52: Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.

4. Shpenzime energji elektrike. Bashkia Kurbin ka likuiduar për vitin 2023 faturat e OSHEE, por padrejtësisht në këto fatura është shtuar si zë shpenzimi edhe taksa e aparateve (televizorit) prej 100 lekë/rast, (tregu lirë, linjat e ndriçimit rrugor në 4 njësitë vendore dhe në shkollat në

njësitë administrative), në kushtet kur nuk ka aparate televizive, çka ka shkaktuar shpenzime të tepërta, pavarësisht vlerave të vogla (12 njësi x 100 lekë /muaji x 12 muaj), ku bashkia nuk ka kundërshtuar këtë problem, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9, pika 4, neni 12 pika 3.

MAGAZINA 2023.

Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhen në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike.

Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit.

Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

Fletëhyrjet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri dhe për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me faturën elektronike të shitësit, për efekt rekordimi të vlerës të bërë hyrje dhe asaj të likuiduar sipas faturave përkatëse.

Disponohen fletëhyrjet për kalimin kapital të inventarëve të ish-sportelevë të QKB pranë bashkisë (fletëhyrja nr. 4 datë 17.03.2023).

Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri dhe nga marrësi. Fletëdaljet kanë bashkëngjitur autorizim e plan-shpërndarje të miratuar nga eprori ose drejtorja përkatëse e bashkisë (për kancelari, shtypshkrime, bojëra kompjuteri, fotokopje, printer dhe materiale ndërtimi, industriale, sanitare e tjerë).

Fletë daljet dhe Fletëhyrjet e magazinës për vitin 2023 janë prerë sipas numrit kronologjik.

Janë hapur kartela e zyrave, inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Flet inventarët sipas zyrave dhe personave përgjegjës janë të nënshkruara nga personi që i ka në ngarkim dhe nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit bashkisë.

Është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara deri në momentin aktual, domosdoshmëri kjo për të pasur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit, në përputhje me kap III, pika 30 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për vitin 2023 disponohen normativat e harxhimit të karburantit për automjetet e bashkisë Kurbin, miratuar në Këshillin bashkiak, sipas VKB nr. 107 datë 21.12.2022.

Janë mbajtur për çdo muaj fletë-udhëtime në të cilat janë plotësuar të gjitha lëvizjet me destinacionet përkatëse, duke përshkuar distancat në kilometra të tyre të firmosur nga shoferi dhe nëpunësi udhëtues.

Çdo lëvizje e automjeteve shoqërohet me autorizimin e titullares së bashkisë.

Kështu **u verifikuan me zgjedhje fletudhëtimet** e disa automjeteve të vitit 2023 ku u konstatuan disa raste me mangësi me efekte të papërfillshme, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, konkretisht:

-Automjeti me targa AA...MO,

-Automjeti me targa AA...PX drejtues Sh. B, ku u konstatua se në disa raste në fletudhëtimet shtator 2023 vendosen gabimisht distancat për km e përshkuara, konkretisht: Në linjën Laç-Tiranë dhe kthim është vendosur 50 km në vend të 45 km, sipas tabelës miratuar në DPSHTRR Tiranë. Po kështu në linjën Laç –Lezhë është vendosur 25 km, pra i bie 75 km linja Lezhë-Tiranë, ku ajo është 65 km sipas tabelës së miratuar të kilometrazhit midis rretheve.

-Automjeti me targa AA...KH, drejtues S. T, ku u konstatua se në fletudhëtimet e vitit 2023 pasqyrojnë lëvizje të shpeshta, për çdo ditë, madje 2 herë në ditë kryesisht në linjën Laç – Tiranë dhe kthim, e cila nuk justifikon qëllimin e shërbimit, fakt për këtë janë autorizimet të cilat citojnë një arsye tip maket për gjitha rastet për nevoja pune të bashkisë, pa përcaktuar saktë qëllimin e shërbimit.

-Automjeti me targa AA...KH, drejtues P. M ku u konstatua në fletudhëtimet e vitit 2023 ndryshim të distancës të km për te njëjtën linjë Laç-Milot dhe kthim, pra me 2 standarde, pasi linja Laç-Milot është pasqyruar 30 km dhe 40 km vajtje-ardhje, ndërsa në rastet e makinave të tjera pasqyrohet 20 km vajtje-ardhje, sipas miratimit të kilometrazhit nga qendra.

Në fund të muajit fletë udhëtimi është bërë rakordimi i karburantit të furnizuar me harxhimin e tij, sipas normativave të miratuara për 100/km, por km e përshkuara nuk janë verifikuar në (kroskotin) automjeteve apo në aktkolaudimin (kontrolli teknik) të tyre, për efekt të saktësisë të km të pasqyruara në fletudhëtimet.

Sa më sipër, për mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e automjeteve kanë përgjegjësi drejtuesit e automjeteve z. Sh. B, z. S. T dhe z. P. M, specialistja e financës që mbulon magazinën znj. L. R, dhe znj. R. K, me detyrë Drejtore e Financës.

Inventarizimi i pasurisë 2023.

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet të evidentuara në pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” evidentuar në pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimin, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.

Për vitin 2023 është kryer inventarizimi fizik i pasurisë të institucionit, njërive administrative, gjendjeve civile, shkollave, kopshteve e Çerdheve, Qendrës Ekonomike të Kulturës, Sporteve, Agjencia e kullimit dhe vaditjes, Agjencia e mirëmbajtjes së rrugëve rurale, PMNZSH.

Komisioni i inventarizimit i ngritur sipas urdhrat të kryetarit të Bashkisë nr. 137 datë 08.09.2023, përbëhet nga z. P. B, znj. F. M, z. A. V, z. T. S, znj. L. T, z. A. P, znj. J. Ç, znj. L. P, znj. L. B, znj. O. znj. D. S, z. A. Gj, znj. S. S, znj. Gj. U dhe znj. A. B.

Komisioni është ndarë në grupe inventarizimi, sipas njërive dhe institucioneve, përkatësisht: Bashkia Kurbin 3 veta, Arsimi Laç 3 veta, Njësia Milot 3 veta, Njësia Mamurras 3 veta, Njësia Fushë Kuqe 3 veta.

Komisioni ka kryer inventarizimet, fletët e inventarizimit ishin plotësuar në gjithë ekstremitetet e tyre, dhe ishin nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe personi përgjegjës që i kishte në ngarkim, sipas kërkesave të pikës 82 në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë publike”.

Në përfundim komisioni ka bërë përmbledhjen e inventarizimit duke i ndarë sipas njërive dhe llogarive përkatëse: 214, 215, 218, 327.

Në përfundim komisioni ka paraqitur relacion përmbledhës të inventarizimit në Bashkinë Kurbin, sipas kërkesave të pikës 87, 88, 89, 90, 91 dhe 92 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për vitin 2023 nuk ka nxjerrje jashtë përdorimit të materialeve dhe pajisjeve.

Nga auditimi rezultuan edhe mangësi, si vijon:

a. Nuk përcaktohet numëri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit në procesverbalet e komisionit para fillimit të inventarizimit, procesverbal i cili mungon, në kundërshtim me pikën 83 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

b. Pavarësisht se për vitin 2023 nuk ka nxjerrje jashtë përdorimit të materialeve dhe pajisjeve, por komisioni duhej të evidentonte me specialistë të fushës humbjen e vlerës përdorimit, vitin e prodhimit dhe amortizimin e tyre, sipas kërkesave të pikës 95 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”.

Sa më sipër, për të metat e konstatuara mbajnë përgjegjësi znj. M. C me detyrë Kryetare e Bashkisë, znj. R. K me detyrë Drejtore e Financës, si dhe komisionin e inventarizimit z. P. B, znj. F. M, z. A. V, z. T. S, znj. L. T, z. A. P, znj. J. Ç, znj. L. P, znj. L. B, znj. O. K, znj. D. S, z. A. Gj, znj. S. S, znj. Gj. U dhe znj. A. B.

4.4. Verifikimi i inventarëve të aktiveve afatgjata materiale, sa janë me certifikatë pronësie.

Kontabilizimi dhe inventarizimi i Aseteve.

Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në Bashkinë Kurbin, u konstatua se **janë zbatuar dispozitat e VKM-së nr. 510, datë 10.06.2015** “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve trupëzuara dhe patrupëzuara, të arkivave e çdo dokumentacioni tjetër zyrtar njësitë vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

Bashkia Kurbin ka miratuar listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të saj dhe të pronave të transferuara nga ish-komunat sot njësitë administrative, gjatë viteve të mëparshme nga shkrirja e komunave në vitin 2015 dhe në vazhdim.

Regjistrimi në kontabilitet i asetëve është bërë pjesërisht nga bashkia Kurbin, në zbatim të pjesshëm të ligjit 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat paluajtshme”, të ligjit 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin pronave të paluajtshme publike në Njësitë Vendore”, të VKM 500 datë 14.8.2001 “Për inventarizimin PP Shtetërore dhe transferimin pronave në Njësitë Vendore”, konkretisht:

- **Bashkia Kurbin disponon gjithsej 3,309 prona të paluajtshme**, përkatësisht: shkolla, troje, sheshe, pemëtore, zyra, rrugë, pyje, kullota etj.

Pronat e Bashkisë Kurbin janë të transferuara me VKM nr. 467 datë 18.07.2012, me VKM nr. 114 datë 13.02.2013, me VKM nr. 1054 datë 16.07.2008 dhe me VKM nr. 307 datë 10.04.2013.

- **3,145 prona të paluajtshme nuk janë regjistruar në kontabilitet.**

- **164 prona të paluajtshme janë regjistruar në kontabilitet**, përkatësisht troje, rrugë, ndërtesa, rrjete etj., me vlerë totale 3,191,209,826 lekë në vlerë historike, sipas VKM dhe njërive administrative pasqyryar në kapitullin Anekse, tabela nr.33, bashkëngjitur raportit përfundimtar të auditimit.

Rregjistrimi në ASHK dhe pajisja me certifikatë pronësie të Aseteve

* Bashkia Kurbin për vitin 2023 nuk ka aplikuar pranë ASHK Lezhë dhe **nuk ka pajisur me certifikatë pronësie 3,309 prona të paluajtshme** shtetërore në territorin brenda juridiksionit saj.

Zyra e Aseteve dhe Juridike që mbulon pronësinë nuk ka marrë asnjë masë për regjistrimin pranë ASHK të këtyre pasurive, për pajisjen e tyre me certifikatë pronësisë, fakt është mungesa e shkresës në adresë të financës dhe kadastrës.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” neni 18 ku citohet se:

“Të gjitha pronat, të cilat u kalohen në pronësi njësive të qeverisjes vendore, sipas këtij ligji, do të regjistrohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me pronar njësinë përkatëse të qeverisjes vendore”;

Me ligjin nr. 20/2020 “Për Kadastrën”, neni 43 “tarifat e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2, e cila favorizon regjistrimin e pronave shtetërore me shërbime të reduktuara, me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 37, 42, 60, 74, me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21, 22.

Pyje dhe kullota publike brenda juridiksionit të territorit të bashkisë Kurbin, rezultojn sipërfaqe prej **11,350 ha**, nga kjo **154 ha kullotë dhe 11,196 ha pyll** dhe shkëmbore, në zbatim të VKM nr. 471 datë 16.04.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje e

kullota që transferohen në pronësi të qeverisjes vendore Mamurras”, me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive”, ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullota publike”,

Sipërfaqja pyjore e kullosore të transferuara nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe nuk janë pajisur me certifikatë pronësie pranë ASHK Lezhë.

Pronat në pronësi/përdorim të certifikuar ose jo nuk ka të lëshuar me kontratë qiraje. Nuk ka plan menaxhimi të ekonomisë pyjore të miratuar, për vitin 2023.

Lidhur me Asetet e paregjistruara në kontabilitet dhe mos marrjen e masave për paisjen e tyre me certifikatë pronësie ngarkohet me përgjegjësi drejtoresha e financës R. K, përgjegjësi i aseteve P. B dhe përgjegjësjë e kadastrës R. P.

Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.

Bashkia Kurbin për vitin 2023 nuk ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore, pasi nuk ka njësi varësisë. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nën njësisë. Për mënyrën e plotësimit të pasqyrave financiare, për saktësinë dhe analizën e llogarive të pasqyruara dhe të paraqitura në aktiv dhe në pasiv të bilancit janë trajtuar hollësisht në pikën një të programit, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike. Për vlerësimin dhe dhënien e opinionit të pasqyrave financiare për vitin 2023, u analizuan të gjithë treguesit e aktivitetit të veprimtarisë ekonomiko financiare dhe në mënyrë përmbledhëse do të paraqitet së bashku me opinionin në projekt raportin dhe raportin përfundimtar të auditimit.

III.2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit janë administruar evidencat si mëposhtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Kurbin
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastrë
- Inventari i fondit pyjor
- Kontratat e lidhura për dhënien me qira të fondit pyjor

I. PASURITË E PALUAJTSHME

Sipas ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë janë të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për Bashkinë Kurbin (ish Bashkia Laç), lista e pronave është miratuar me VKM nr. 467, datë 18.07.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim në Bashkinë Kurbin, Qarku Lezhë”. Për 3 Njësitë Administrative, rezulton se nuk ka të miratuara lista përfundimtare të pronave, që kalojnë në pronësi/përdorim të tyre, por ky proces ka mbetur në nivel të miratimit të listave paraprake, ku për secilën njësi administrative, rezulton:

Tabela nr. 25

Nr.	Bashkia/Njësitë	Nr. Pronave në Inventar	Në pronësi	Në përdorim	Prona të regjistruara në Kadastrë
1	Bashkia Kurbin	1.527	670	337	-
2	NJA. Mamurras	1.464			Nuk ka listë përfundimtare (Regjistruar vetëm pasuria nr. 2/44 Truall 2000 m ²)
3	NJA. Fushë Kuqe	131			Nuk ka listë përfundimtare
4	NJA. Milot	527			Nuk ka listë përfundimtare
Totali		3.694	670	337	

Për NJ.A. Administrative Mamurras (ish Bashkia Mamurras), me VKM nr. 114, datë 13.02.2013, është miratuar lista paraprake për transferimin e 42 pronave, me qëllimin afishimin dhe përditësimin e tyre.

Për NJ.A. Administrative Fushë Kuqe (ish-Komunën Fushë Kuqe), me VKM nr. 307, datë 10.04.2013, është miratuar lista paraprake për transferimin e 64 pronave, me qëllimin afishimin dhe përditësimin e tyre.

Për NJ.A. Administrative Milot (ish-Komunën Milot), me VKM nr. 1054, datë 16.07.2008, është miratuar lista paraprake për transferimin e 692 pronave, me qëllimin afishimin dhe përditësimin e tyre.

Referuar VKM-së nr. 467, datë 18.07.2012, që ka miratuar listën përfundimtare të pronave për Bashkinë Laç, sipas llojit të funksionit, rezultojnë të dhënat si mëposhtë:

Tabela nr.26

Funksioni	Pronësi	Përdorim	Të regjistruara
Për realizimin e shërbimeve arsimore	27	-	-
Për shëndetin publik	3	-	-
Për sportive realizimin e veprimtarive social kulturore e	8	-	-
Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	32	-	-
Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave	-	333	-
Porna në infrastrukturë(sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	511	-	-
Varreza publike	3	-	-
Prona në fushën e shërbimit social	1	-	-
Prona që përdoren për funksione në fushën e bujqësisë dhe ushqimit(toka produktive)	-	4	-
Prona që përdoren për funksione në fushën e bujqësisë dhe ushqimit(toka jo produktive)	4	-	-
Prona që përdoren për funksione në fushën e kanalizimeve	7	-	-
Prona që përdoren për funksione në fushën e zhvillimit ekonomik	74	-	-
TOTALI	670	337	-

Në total, nga 670 pasuri që i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Kurbin (ish Bashkisë Laç), pa përfshirë ish-komunat, deri në këtë fazë nuk rezultojnë me dokumentacion pronësor, që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar. Megjithëse nga lista e pronave që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin, rezulton se për një pjesë të tyre është aplikuar para vitit 2015, për regjistrimin e tyre në ish ZVRPP Laç, por që nuk asnjë informacion lidhur me vijimin e këtij procesi, deri në certifikimin e pronës, më hollësisht pasqyrohet në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 27, Objekti: Dosjet të dërguara për Rregjistrim pranë ZVRPP-së

Nr.	Aplikimi		Procedura	Lloji i pasurisë
	Nr. Prot	Data		
1	33	10.01.2006	Dërgim dokumtacioni për rregj. Pas.se paluajtshme 1022	Rep. Usht
2	804	22.05.2014	Dërgim dokumtacioni për rregj. Pas. se paluajt. perseritur.	Rep. Usht
3	1089	11.08.2014	Dërgim dok. për regjistrim + permbajtje dosjes se pyjeve	Pvje & kullota
4	728	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Shkolla 9-vjeçare nr. 3 + fature	
5	729	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Shkolla 9-vjeçare nr. 5 + fature	
6	730	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Shkolla 9- vjeçare nr. 1 + fature	
7	731	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Shkolla e Mesme + fature	
8	732	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Shkolla 9-vjeçare nr. 2 + fature	
9	733	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Pallati i Kultures + fature	
10	734	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Fusha e Sportit + fature	
11	735	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Infrastr. Rugore lagj. 6 + fature	
12	736	01.04.2015	Dërg. Dok.për regjistrim Infrastr. Rugore lagje nr. 1, 2, 3, 4, 5 + fature	
13	737	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Kopshti tek Trokthit + fature	
14	738	01.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Çerdhja + Kopshti nr. 1 + fature	
15	817	15.04.2015	Dërgim dok. për regjistrim + permbajtje dosjes se Dr.Arsim.	
16	818	15.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Ambulanca e lagj. Nr. 4 + fature	
17	819	15.04.2015	Dërgim Dok.për regjistr. Sheshi funksional dhe Fusha e Futbollit Laç+ Fature	
18	1051	04.06.2015	Dërgim Dok. për regjistr.“Varrezat Publike lagj.4” + Fature	
19	1052	04.06.2015	Dërgim Dok. për regjistr.“Varrezat Publike lagj.5” + Fature	
20	1053	04.06.2015	Dërgim Dok. për regjistr.“Varrezat Publike lagj.2” + Fature	
21	1054	04.06.2015	Dërgim Dok. për regjistr.“Poligoni i Qitjes” + Fature	
22	1055	04.06.2015	Dërgim Dok. Për regjistr. “Vendstrehimet” + Fature	
23	1050	04.06.2015	Për likujdime të Faturave – Drejtuar Financës	
24	1680	15.082015	Për likujdime të Faturave – Drejtuar Financës	

Rezultoni se me Urdhrin nr. 311, datë 20.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kurbin, është ngritur grup pune për të bërë verifikimin në terren dhe saktësimin e të dhënave për pronat e miratuara VKM nr. 467, datë 18.07.2012, ku rezulton se grupi i punës për periudhën 13.02.2017 deri

31.03.2017, ka mbajtur 379 procesverbale ku pasqyrohen të dhënat e evidentuara për 379 prona që ndodhen në territorin e qytetit të Laçit.

Gjithashtu në vijimësi të këtij procesi me Urdhrin nr.125, datë 29.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kurbin, është ngritur grup pune (komision), për inventarizimin fizik për aktivet e paluajtshme në pronësi të bashkisë, me synimin për krijimin e regjistrit të pronësisë. Referuar informacionit të Grupit të punës datë 24.01.2023, rezulton të jenë evidentuar dhe inventarizuar:

- Në njësinë Laç janë inventarizuar 4 shkolla 9 vjeçare, 1 shkollë e mesme dhe 3 kopshte, si dhe ish Poligoni i qitjes dhe Stadiumi i Laçit. Gjithashtu janë inventarizuar 3 vendstrehime (1 ka rezultuar i okupuar), si dhe janë evidentuar në total 361 troje, nga të cilët 186 troje kanë rezultuar të zëna;
- Në njësinë Mamurras janë inventarizuar 7 shkolla 9 vjeçare, 1 shkollë e mesme dhe 2 kopështe, si dhe ish Bashkia e vjetër dhe godina e Njësisë Administrative Mamurras,
- Në njësinë Milot janë inventarizuar 10 shkolla 9 vjeçare, 1 shkollë e mesme;
- Në njësinë Fushë Kuqe janë inventarizuar 4 shkolla 9 vjeçare, 1 shkollë e mesme;

Duke ju referuar afatit të urdhërit si dhe numërit të pasurive që janë inventarizuar dhe evidentuar në terren, rezulton se ky proces ka vazhduar me ritme të ngadalta, duke mos ju përgjigjur në kohë procesit të regjistrimit të pasurive që administron Bashkia Kurbin.

Nga verifikimi i evidencave, rezulton se:

- Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Kurbin nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i pa përditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se *“bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji”*.
- Në total, nga 670 pasuri i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Kurbin, pa përfshirë ish-komunat, rezultojnë të pa regjistruara në kadastër, pra nuk kanë dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar. Në veçanti konstatohet vërehet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, ndonëse për to ka realizuar investime përgjatë viteve.
- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Kurbin nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të inventarit të pronave të bashkisë.

Sa më sipër mban përgjegjësi z. P. B me detyrë Përgjegj. i Sektorit zhvillimit ekonomik, Aseteve dhe Statistikave, z. D. K dhe z. A. V me detyrë specialist në Agjensinë e administrimit të pyjeve dhe kullotave.

II. Fondi Pyjor

Bashkia Kurbin ka në administrim një fond pyjor dhe kullor prej 11317.9 ha, i ndarë në 6 ekonomi pyjore, sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar.

Tabela nr.28, Të dhëna statistikore të vitit 1985

Ekonomia Pyjore	Sipërfaqe total HA	shkembore	pyll	kullote
Skenderbe	3387		3387	
Mal-Bardhe	2750		2750	
Milot-lester	2800		2800	
Shkopet	740		740	
Shemri-Brrer	1520		1444.1	75.9
Fushë Kuqe	120.9		42.8	78.1
Totali	11317.9	-	11163.9	154 ha

Nga auditimi ka rezultuar se:

- Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Kurbin nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore.
- Sipas pikës 66 të VKM nr. 443/2016 nuk ka regjistruar në regjistrat kadastral sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullozor. Gjithashtu nuk janë kryer verifikime dhe saktësimet përkatëse në terren, lidhur me gjendjen faktike të ngastrave pyjore, pasi të dhënat që disponon Bashkia Kurbin i referohen statistikave para vitit 1990.
- Sipas VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullozor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Bashkia Kurbin nuk ka ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ.

Në Bashkinë Kurbin nuk rezulton të jenë lidhur kontrata gjatë periudhës objekt auditimi, por vazhdojnë në proces kontrata të lidhura më parë. Janë lidhur gjithsej 3 kontrata për dhënie në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor, nga të cilat 2 kontrata kanë si objekt aktiviteti përdorim në funksion për “Hidrocentral” dhe 1 kontratë për përdorim për ndërtim dhe montim “Antenash”. (Likujdimi i detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e lidhura, është trajtuar në pikën 3 të programit të auditimit).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4144 prot., datë 04.09.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 750/4 prot., datë 10.09.2024, nga Z/Kryetari i Bashkisë z. F. P, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit: Lidhur me trajtimin për menaxhimin e fondit pyjor, ku shpreheni se: ..Bashkia Kurbin nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore..... . Nuk janë kryer verifikime dhe saktësime në terren, lidhur me gjendjen faktike të ngastrave pyjore... . Në përgjigje edhe të rekomandimit nr. 8.1 të lënë në projekt raportin e auditimit, sqarojmë se:

Bashkia Kurbin ka mungesë fondesh për të realizuar planet e mbarështimit të ekonomive pyjore, për këtë i jemi drejtuar edhe Ministrisë së Mjedisit, për të na mbështetur me fonde...

Gjithashtu kemi bërë verifikime duke menaxhuar të gjithë fondin pyjor brenda mundësive tona si bashki, duke sqaruar se ka mungesë të personelit lidhur me përcaktimin e ndryshimeve të zërit kadastral(pesona i caktuar për këtë detyrë, është në proces trajtimi)

Për të dhënat e viteve 1990, që ju keni cituar, sqarojmë se jemi në pritje të procesit të regjistrimit nga ASHK, për këtë i jemi drejtuar ASHK Kurbin për të marrë informacion lidhur me ecurinë e procesit të regjistrimit të pyjeve dhe kullotave..... . Në momentin e plotësimit të këtyre kërkesave, Bashkia Kurbin do të vijojë me përbushjen dhe realizimin e këtij procesi.... .

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Lidhur me observacionin e paraqitur, të sipërcituar, sqarojmë:

Observacioni juaj është sqarues përse i përket situatës dhe faktorëve që kane ndikuar në realizimin e procesit të administrimit të pyjeve dhe kullotave, por nuk ka asnjë argument kundërshtues lidhur me konstatimet tona për këtë çështje, për rrjedhojë për ato mbeten të pandryshuara, po ashtu edhe rekomandimi i lënë për përmirësimin e kësaj situatë.

Për veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara janë përgjegjësi e znj. M. C me detyrë Kryetare e Bashkisë, z. P. B me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik, Aseteve dhe Statistikave, z. D. K dhe z. A. V me detyrë specialistë në Agjensinë e administrimit të pyjeve dhe kullotave.

III. 2.6. Të ndryshme të dala gjatë auditimit (Ankesa).

Në lidhje me ankesën e administruar në KLSH me nr. 413/1 prot., datë 05.04.2024 depozituar nga qytetari A. M.

Nga ankuesi pretendohet se Bashkia Kurbin ka kryer veprime të pa mbështetura në ligj, pasi ka depozituar mbetje inerte të depozituara nga shembjet e tërmetit të 26 Nëntorit 2019, në tokë bujqësore e cila është pronë private, e tjetërsuar tre herë dhe që është regjistruar me dokumente të falsifikuara. Gjithashtu pretendohet se kjo tokë bujqësore është kthyer në truall, si dhe grumbullimi i mbetjeve është kryer në mungesë akteve ligjore dhe të lejes mjedisore, duke pretenduar se vend depozitimi i mbetjeve të inerteve ka qenë përcaktuar në Porto Romano Durrës, ku edhe janë raportuar, ndërsa në fakt ato janë depozituar në këtë vend depozitim që ndodhet në Laç,

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, kërkoi informacion dhe dokumentacionin përkatës nga Bashkia Kurbin. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se:

Me vendimin nr. 50, datë 17.12.2019, Këshilli i Bashkisë Kurbin ka miratuar: “Marrjen në përdorim të përkohshëm pa kundër shpërblim të pasurisë nr. 28/8, zona kadastrale 2365 me sipërfaqe 9000 m², për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve inerte të krijuara nga dëmtimi i banesave për shkak të tërmetit”. Ky vendim i Këshillit bashkiak është konfirmuar me Vendimin nr. 1686/4, datë 19.12.2019 të Prefektit të Qarkut Lezhë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se pasuria nr. 28/8, volum 2, faqe 45, e llojit “arë” me sipërfaqe 9000 m², zotërohet me dokumentacion pronësie (certifikatë pronësie datë 10.10.2000, lëshuar nga ZVRPP Laç) nga qytetari M. Gj (aktualisht zgjidhja e çështjes së pronësisë për këtë pasuri vazhdon në proces gjyqësor), i cili pas pasojave të krijuara nga tërmeti, i është përgjigjur kërkesës së Bashkisë Kurbin, me shkresën datë 15.12.2019, si qytetar i këtij komuniteti dhe në cilësinë e anëtarit të këshillit bashkiak, ka ofruar kontributin e tij, duke vënë në dispozicion të përkohshëm të Bashkisë Kurbin, pasurinë nr. 28/8, “arë” me sipërfaqe 9000 m², për të cilën ka disponuar dokument pronësie.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se nuk janë zbatuar procedurat e përcaktuara për vend grumbullimet e përkohshme, si dhe nuk rezulton të ketë leje mjedisore, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, e argumentuar nga Bashkia Kurbin, se kjo vjen për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar nga pasojat e tërmetit, kjo referuar edhe VKM-së nr. 751, datë 29.11.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 750, datë 27.11.2019”, duke shpallur “Gjendjen e fatkeqësisë natyrore në Qarkun Lezhë”. Nga Bashkia Kurbin argumentohet se në kushtet e krijuara dhe nevoja për veprime sa më të shpejta, nuk ka qenë e mundur ndjekja e procedurave ligjore, pasi çdo vonesë në kryerjen e veprimeve, kërcënonte sigurinë e jetës së qytetarëve. Në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore është vepruar në mënyrë emergjente për largimin e mbetjeve të inerteve të krijuar nga banesat e shembura dhe ato që kanë rezultuar të dëmtuara plotësisht, për rrjedhojë nuk rezulton të ketë dokumentim të procesit të largimit dhe depozitimit të mbetjeve. Në këto kushte tepër të vështira, i është dhënë prioritet normalizimit të gjendjes dhe garantimit të sigurisë së jetëve të qytetarëve, për këtë janë mobilizuar dhe angazhuar mjete të ndryshme të ofruara nga subjekte private dhe institucione shtetërore të ndryshme. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk rezulton i dokumentuar dërgimi i mbetjeve në Porto Romano, pasi nuk ka asnjë marrëveshje, vendim apo urdhër që të ketë përcaktuar këtë venddepozitim për mbetjet inerte të krijuara nga tërmeti në Bashkinë Kurbin.

Referuar sa më sipër, arrijmë në konkluzionin se mos përmbushja e kërkesave për vend depozitimet e përkohshme të përcaktuara në VKM Nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, argumentohet me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, dhe ka funksionuar si vend depozitim vetëm për depozitimin e mbetjeve të inerteve të banesave të shembura nga tërmeti. Aktualisht Bashkia Kurbin nuk ka të miratuar landfill për depozitimin e mbetjeve inerte, për të bërë të mundur depozitimin dhe transportimin e këtyre mbetjeve në landfillin e përcaktuar. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se zëri kadastral i pasurisë nr. 28/8, nuk ka pësuar ndryshim, ka të përcaktuar zërin kadastral “arë”.

Për sa trajtuar, është mbajtur aktverifikimi nr. 1 me Z/Kryetarin e Bashkisë Kurbin.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

-Mbledhjen e GSM, e cila nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

- Në Bashkinë Kurbin nuk janë hartuar “Hartat e proceseve të punës”.

- Për sa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e MFK-së, nuk është parashikuar dhe hartuar një program trajnimi, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet dhe zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit përveç trajnimeve që janë organizuar nga ASPA.

-Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengojnë marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

-Regjistri Elektronik për familjarët në qytet dhe në 4 Njësitë Administrative mbahet në formatin Excel (ndërtesë, truall, tokë bujqësore, etj), në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

-Bashkia Kurbin ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT.

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njëjësive të varësisë të saj.

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, neni 8. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 12-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Gjithashtu, të merren masa për vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licensuar, për mbajtjen administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është e plotë, pasi aktualisht funksionon me një auditues/përgjegjës sektori. Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, që kryhet nga NjAB, u konstatua se nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në këtë bashki, dhe gjithashtu nga përgjegjësi i këtij sektori nuk është kryer zbatimi i rekomandimeve për 6-mujorin paraardhës nga sektori i Auditit të Brendshëm, këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Neni nr.12 dhe “Manuali i auditimit të brendshëm në sektorin publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1.1, faqe 22-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, të merren masa për kryerjen e zbatimit të rekomandimeve për 6-mujorin paraardhës të lëna nga NJAB. Nga Kryetari i Bashkisë Kurbin, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm si dhe ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: U konstatua se detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve deri me datë 30.11.2023 në Bashkinë Kurbin, paraqiten për vlerën 55,981 mijë lekë, vlerë e cila do të rëndojë në buxhetin e vitit 2024 krahas likuidimeve të radhës. Detyrimet e prapambetura të pa likuiduara përbëhen nga këto zëra analitikë, sa vijon:

-Vlera 6,222 mijë lekë, investime nga Bashkia.

-Vlera 36,026 mijë lekë, energji elektrike.

-Vlera 9,761mijë lekë, mallra dhe shërbime.

-Vlera 3,972 mijë lekë, vendime gjyqësore. Përgjatë vitit 2023, Bashkia Kurbin nuk ka kryer asnjë pagesë të vendimeve gjyqësore.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, ç’ka do të thotë se **Bashkia Kurbin në fund të vitit 2023 rezulton në një situatë normale.**

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 24-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 55,981 mijë lekë, duke marrë masa për reduktimin e shpenzimeve, rritjen e të ardhurave vendore, mbledhjen e arkëtimit e debitorëve, kërkimin e çeljes së fondeve nga qendra sipas burimit të financimit të investimeve të kryera.

Brenda vitit 2024

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale, të trupëzuara të planifikuara, paraqitet në nivele të ulta në vitin 2023, konkretisht në masën 69%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kurbin në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën

“a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 24-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, Drejtorja e Financës dhe Drejtorja e të Ardhurave, të marrë masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2023 rezulton me diferenca, realizim e zbatim në masën 64 %; Ndryshimet e bëra në buxhet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit. Nuk ka një analizë se si ndikojnë këto ndryshime në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë. Nuk janë analizuar mos realizimet sipas zërave përkatës dhe nuk ka nxjerrë shkaqet sipas sektorëve. Nuk janë planifikuar shpenzime për regjistrimin e aseteve të kaluara në përdorim të Bashkisë Kurbin. Nuk janë të dokumentuara në hartimin e buxhetit e konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 47, ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore” shtojca 4, pika c. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 24-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bilancit 2023 u konstatua se:

- **Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët paraqitet në vlerën 376,772,122 lekë, që përfaqëson debitorët e taksave vendore, taksës infrastrukturës Aluiznit dhe debitorë të tjerë, grafiku i së cilës është në rritje për 57,762,488 lekë, krahasuar me vitin e mëparshëm 2022, (debitorë në fillim 2023 paraqitet 319,009,634 lekë, shtuar 68,914,119 lekë, pakësuar 11,151,631 lekë).

- **Llogaria 423- 429 “Debitorë personeli gjoba dhe KLSH”** paraqitet për vlerën debitorë prej 50,196,468 lekë, që përfaqëson gjoba të ndryshme të mbartura 48,610,343 lekë dhe zbulime të KLSH të mbartura 1,586,125 lekë.

Bashkia nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjore, për arkëtimin e vlerës debitorë llogaria 468 prej 376,772,122 lekë dhe vlerës debitorë prej 50,196,468 lekë, llogaria 423-429 në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, me ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe me ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi Procedurave Administrative në RSH” nenet 98 dhe 102. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe nr. 45-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore, për arkëtimin e vlerës debitorë **376,772,122 lekë, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”** për arkëtimin e vlerës debitorë **50,196,468 lekë, llogaria 423- 429 “Debitorë personeli gjoba dhe KLSH”**.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të arkës në Bashkinë Kurbin, për vitin 2023 u konstatuan këto mangësi, si vijon:

-Të gjitha mandat arkëtimet (MA) për vitin 2023 nuk kanë nënshkrimin e financës, por vetëm me firmën e arkëtares.

-Të gjitha mandat pagesat (MP) për vitin 2023 nuk kanë nënshkrimin e financës dhe drejtuesit, por vetëm me firmën e arkëtares.

-Libri i arkës nuk ka nënshkrimet e përgjegjësës së financës, për mbylljet mujore të gjendjes fizike të arkës, për efekt rakordimi financë-arkëtar.

-Arkëtimet janë kryer nëpërmjet arkës, në vend të derdhjes tyre në bankë, për taksat dhe tarifat vendore nga taksapaguesit si dhe për shërbimet e ndryshme të tjera, ç'ka bie ndesh me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 61 dhe 64.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik", pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe nr. 45-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masa për dokumentimin e plotë dhe të saktë të veprimeve me arkën, si dhe administrimin e dokumentacionit me elementët e formës dhe përmbajtjes.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet, se për vitin 2023, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 156,676 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 101,089 mijë lekë ose 65 % më pak se planifikimi.

Gjithashtu ekzistojnë disa zëra për të cilat Drejtoria e të Ardhurave nuk ka bërë planifikim për vitin 2023. Përkatësisht, zërat e të ardhurave nga qiratë për tokën, qira për troje, qira për ndërtesat, të ardhura nga ndërmarrjet e tjera (shitje e asetëve) etj., taksën e zënies së hapsirës publike, taksa për fjetjen në hotel, etj.,

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 92, datë 18.01.2022 "Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kurbin për vitin 2023", VKB nr. 106, datë 21.12.2022, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023". (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe nr. 31-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave në Bashkinë Kurbin të marrë masa që në planin vjetor të të ardhurave të bashkisë të parashikojë të ardhurat që do të sigurohen nga të gjitha taksat/tarifat e parashikuara në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua një rast likuidimi me vonesë i faturës nr. 183 datë 02.04.2019 të subjektit "S" SHPK, likuiduar për diferencën 3,709,021 lekë, sipas urdhër shpenzimit nr. 1792 datë 12.10.2023, pra **3 vjet me vonesë**, në vend që të likuidoheshin në afatin e duhur prej 30 ditë, në kundërshtim me: UMF 5 datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", me Udhëzimin plotësues "Për buxhetin e vitit", pikat 82-91 "Detyrimet e prapambetura në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe nr. 31-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhetin vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

Përgjatë vitit buxhetor 2024 dhe në vijim

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i asetëve të Bashkisë Kurbin për vitin 2023, lidhur me kontabilizimin dhe pajisjen me certifikatë pronësie të tyre, u konstatua se Bashkia Kurbin disponon gjithsej 3,309 prona të paluajtshme, përkatësisht: shkolla, troje, sheshe, pemëtoje, zyra, rrugë, pyje, kullota. Nga këto rezulton se me VKM nr. 467, datë 18.07.2012, janë

transferuar “në pronësi” të Bashkisë Kurbin (ish Bashkia Laç), gjithsej 670 pasuri, të ndodhura në Qytetin e Laçit. Nga pasuritë e kaluara në pronësi, asnjë pasuri nuk rezulton me dokumentacion pronësor, ndërsa për një pjesë të tyre është aplikuar para vitit 2015, për regjistrimin e tyre në ish ZVRPP Laç, por që nuk ka asnjë informacion lidhur me vijimin e këtij procesi, deri në certifikimin e pronës (pasqyruar në tabelën “*Dosje të dërguara për regjistrim në ish ZVRPP*”).

Regjistrimi në kontabilitet i asetëve është bërë pjesërisht nga bashkia Kurbin. Bashkia Kurbin ka regjistruar në kontabilitet 164 prona të paluajtshme, përkatësisht troje, rrugë, ndërtesa, rrjete etj., me vlerë totale 3,191,209,826 lekë në vlerë historike.

* **3,145 prona të paluajtshme nuk janë regjistruar në kontabilitet**, këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” ndryshuar me ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, me UMF 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik*”.

* **3,309 prona të paluajtshme nuk janë pajisur me certifikatë pronësie** pranë ASHK Lezhë, madje nuk ka pasur as aplikime për vitin 2023.

* **Pyje dhe kullota publike të transferuara** brenda juridiksionit të territorit të bashkisë Kurbin, rezulton sipërfaqja prej 11,350 ha, nga kjo 154 ha kullotë dhe 11,196 ha pyll, të cilat **nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe nuk janë pajisur me certifikatë pronësie** pranë ASHK Lezhë.

Bashkia Kurbin për të bërë saktësimin e të dhënave dhe për inventarizimin fizik për aktivet e paluajtshme në pronësi të bashkisë, janë ngritur grupe pune sipas Urdhrit nr. 311, datë 20.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kurbin dhe më pas me Urdhrin nr.125, datë 29.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kurbin, ndërsa ky proces rezulton i pa përfunduar, për rrjedhojë inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të pasurive, kjo edhe në mungesë të rakordimit me Zyrën Vendore të ASHK-së Kurbin.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “*Për transferimin pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore*” neni 18, me ligjin nr. 20/2020 “*Për Kadastrën*” neni 43/1/ 2, VKM Nr. 28, date 27.01.2023 “*Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve*” me UMF 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pikat 37, 42, 60, 74, me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, me pikat 20, 21, 22. 102.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, III.2.5faqe nr. 45-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa për kontabilizimin dhe pajisjen me certifikatë pronësie të pasurive të paluajtshme të saj, përkatësisht: shkolla, troje, sheshe, pemëtore, zyra, rrugë, pyje, kullota e tjerë konkretisht:

* Për regjistrimin në kontabilitet të 3,145 pronave të paluajtshme të pakontabilizuara,

* Për pajisjen me certifikatë pronësie të 3,309 pronave të paluajtshme pa titull pronësie,

* Për regjistrimin në kontabilitet dhe pajisjen me certifikatë pronësie të 11,350 ha pyje dhe kullota publike të transferuara (154 ha kullotë dhe 11,196 ha pyll).

Menjëherë

10.2.Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa që të përfundojë procesin e saktësimit në terren të pronave dhe të rakordojë me Zyrën Vendore të ASHK-së Kurbin, duke kërkuar informacion lidhur me ndryshimet e mundshme të statusit juridik të pronave të bashkisë, për të vijuar me procesin e regjistrimit të pasurive dhe krijimin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave, që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Kurbin.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me administrimin dhe regjistrimin e pronave, për tre ish-komuna, Mamurras, Milot dhe Fushë Kuqe, rezultojnë të miratuara vetëm “listat paraprake”, ndërsa nuk rezulton të jene miratuar “listat përfundimtare” për kalimin e pronësisë. Gjithashtu rezulton se inventarët e pasurive të paluajtshme nuk

përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, pasi inventari rezultoi i pa përditësuar, sipas përcaktimeve në nenin 37, të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe nr. 62-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa, për të përditësuar pronat e tre komunave, të miratuara në “Listat paraprake”, për të vijuar procesin me hartimin e “Listave përfundimtare” të këtyre pronave, duke i përcjellë më pas për miratim në Këshillin e Ministrave, për të bërë të mundur kalimin në pronësi të Bashkisë Kurbin.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kurbin, në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, nuk ka kryer verifikime dhe saktësimet përkatëse në terren, për të ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor, brenda juridiksionit të saj administrativ, pasi të dhënat që disponohen nga kjo bashki, i referohen statistikave para vitit 1990. Gjithashtu nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonominë pyjore, si dhe nuk ka proceduar për regjistrimin e tyre në regjistrat kadastral.

Këto veprime janë në mos përputhje me referencat ligjore përcaktuara në nenin 17 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, në pikën 66 të VKM nr.443/2016 dhe VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullësor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe nr. 62-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa, për të verifikuar dhe saktësuar në terren të gjitha ngastrat pyjore brenda juridiksionit të saj administrativ, për të bërë të mundur ngritjen dhe përditësimin e regjistrit për fondin pyjor kullësor. Gjithashtu të marrë masa për të planifikuar fonde për hartimin e planeve të mbarështimit, si dhe regjistrimin e sipërfaqeve pyjore/kullësore në regjistrat kadastral të pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i ankesës së administruar në KLSH me nr. 413/1 prot, datë 05.04.2024, rezultoi se Bashkia Kurbin në kushtet e krijuara nga tërmeti i vitit 2019, ka përcaktuar një vend depozitim të përkohshëm për depozitim të mbetjeve inerte të krijuara nga shembjet e ndërtesave, që rezultoi i miratuar me Vendimin nr. 50, datë 17.12.2019 të Këshilli i Bashkisë Kurbin, i cili ka funksionuar në kushtet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, kjo referuar VKM-së nr. 751, datë 29.11.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 750, datë 27.11.2019”. Nga informacioni i marrë në Bashkinë Kurbin, rezultoi se ky vend depozitim i përkohshëm, ka shërbyer vetëm për një periudhë deri në largimin e mbetjeve të inerteve të krijuara nga shembja e ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti, ndërsa aktualisht Bashkia Kurbin nuk ka të miratuar landfill vendor, si dhe nuk ka lidhur marrëveshje me njësi të tjera vendore, për të depozituar mbetjet inerte në landfillet rajonale, sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në VKM Nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.6, faqe nr. 66-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa, për të lidhur marrëveshje me njësi të tjera vendore, që kanë në administrim landfillet rajonale, për të bërë të mundur, që të gjitha mbetjet inerte të krijuara dhe ato që do të krijohen në vijimësi të depozitohen, sipas kërkesave ligjore të përcaktuara.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë

27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Kurbin në vlerën 13,820 lekë, si më poshtë:

